Introduction. The current severe acute respiratory syndrome coronavirus 2 (SARS-CoV-2) or COVID-19 has brought radical changes to the global healthcare system, so the development of an effective therapy is urgently required. The main characteristic shared by COVID-19 patients is represented by an altered immune system that overall may consequently lead to multiorgan dysfunction. The use of natural adjuvants has gained interest and we paid attention to resveratrol, a natural polyphenolic compound known for its immunomodulating, anti-inflammatory and antiviral properties. Purpose. The purpose of this study was to search for the benefits of using resveratrol in case of infection.

Methods: PubMed and Scopus were the main sources used for our literature search.

Results. Yang et al. demonstrated the antiviral activity of resveratrol in COVID-19 by inhibiting SARS-CoV-2 infection in in vitro cell culture, suggesting its potential effect in vivo also.

There are different mechanisms underlying the antiviral activity of resveratrol, including the inhibition of p38MAPK and PI3K/AKT/mTOR path-

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

ways, involved in inflammation; immune system stimulation; regulation of renin-angiotensin system which modulates the virus entrance in cells and antioxidant activity.

Besides respiratory problems, COVID-19 infection leads to an alteration of vascular homeostasis. Thanks to its antithrombotic and anticoagulant effects, resveratrol mitigates this condition.

However, despite the beneficial effects, the poor oral bioavailability could limit its use.

Conclusions. In conclusion, resveratrol inhibits viral replication of SARS-CoV-2 and plays a powerful anti-inflammatory role. It works by including several mechanisms, giving rise to a synergic effect. However, its pharmacokinetic profile is not the best, therefore it should be established how it can be used optimizing the beneficial effects without encountering side effects.

Keywords: Covid-19, resveratrol, immune system, inflammation

NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 NË JETËSINË E STUDENTËVE. NJË RAPORT RASTI NGA SHQIPËRIA

Enkelejda Goci^{1,2}; Entela Haloçi²; Altin Kulli³; Arsiola Gega^{1}*

¹Universiteti Aldent; Fakulteti i Shkencave Mjekësore; Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike

²Universiteti i Mjekësisë, Tiranë; Fakulteti i Mjekësisë; Departamenti i Farmacisë

³Kolegji Universitar “Qiriazhi”; Fakulteti i Ekonomisë; Departamenti i Menaxhimit të Biznesit

Hyrje: COVID-19 është një krizë globale. Shumica e liderëve botërorë bënë thirrje për izolim me urdhër qëndrimi në shtëpi për qytetarët e tyre. Këto urdhra për qëndrim në shtëpi përfshinë mbylljen e shumicës së shkollave, përfshirë edhe ato të arsimit të lartë. Studentët e universitetit, si të diplomuar ashtu edhe të padiplomuar, të cilët prisnin të ndiqnin dhe të përfundonin kurset e tyre në klasa, i përfunduan kurset e tyre në distancë.

Qëllimi: Në këtë gjendje ne ndërmorrëm një studim për të vlerësuar ndikimin real të pandemisë në stilin e jetesës së studentëve dhe aktivitetin e tyre ekonomik.

Metodologjia: Studimi u organizua në kuadër të një projekti ndërkombëtar “Studimi i kushteve të jetesës së studentëve dhe aktiviteti ekonomik gjatë pandemisë së Covid – 19” mes tre universiteteve: University of Warmia and Mazury in Olsztyn – Poloni, Polytechnic of Porto – Portugali dhe dy Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri, ku secili nga kordinatorët perkates mbulon të dhenat sipas vendeve. Studimi është organizuar përmes një pyetësori Google Form në dy gjuhë. Projekti përfshin një periudhë nga 12.02.2021 deri më 31.12.2023. ku pyetësori përmban 15 pyetje në lidhje me gjininë, kombësinë, fushat e studimit, nivelin programit të studimit, konsumin për aktivitetet e kohës së lirë dhe nevojat bazë, etj.

Rezultatet dhe përfundimet: Për pjesën shqiptare rezultatet e marra për 4 muaj do të prezantohen në këtë konferencë. Pyetësori është plotësuar nga 70 studentë dhe rezultatet pasqyrojnë ndryshimet në stilin e tyre të jetesës dhe kostot ekonomike.

THE IMPACT OF PANDEMIC COVID-19 IN THE LIFESTYLE OF STUDENTS. A CASE REPORT FROM ALBANIA

Enkelejda Goci^{1,2}; Entela Haloçi²; Altin Kulli³; Arsiola Gega^{1*}

1Aldent University; Faculty of Medical Sciences; Pharmacotherapeutic Research Center

2 University of Medicine, Tirana; Faculty of Medicine; Department of Pharmacy

3Qiriazi University College; Faculty of Economy; Department of Business Management

Introduction: COVID-19 is a global crisis. Most world leaders called for self-isolation with stay-at-home orders for their citizens. These stay-at-home orders include the closure of most schools, including those of higher education. University students, both undergraduate and graduate, who expected to take and complete their courses in classrooms, completed their courses remotely.

Purpose: In this condition we undertake a study to evaluate the real impact of the pandemic at the lifestyle of students and their economic activity.

Methodology: This study was organized in the frame of an international project “Study of students’ living conditions and economic activity during the COVID-19 pandemic” between three universities: University of Warmia and Mazury in Olsztyn – Poland, Polytechnic of Porto – Portugal and two Albanian of Higher Education’s Institutions, where each of the respective coordinators covers data for each country.

The organizers have proceeded with a Google form questioner in two languages. The project is extended from 12.02.2021 until 31.12.2023 and the questionnaire contain 15 questions about gender, nationality, fields of study, level of program study, consumption for leisure activities and basal needs, etc

Results and conclusions: For the Albanian part the results obtained for 4 months will be presented in this conference. The questionnaire has been completed by 70 students and the results reflect the changes in their lifestyle and economic costs.

**THERAPIES FOR TREATMENT OF COVID-19:
A LIVING SYSTEMATIC REVIEW**

Ilir Alimehmeti, MD, PhD

Deputy Dean, Faculty of Medicine, University of Medicine, Tirana – Albania

Permanent Member, Health Commission, Academy of Sciences, Albania

Introduction and purpose: Evidence for effective treatment of COVID-19 is both limited and dynamic, despite global efforts of researching and developing effective treatments, including but not limited to more than 3000 different clinical trials. Given such scarce evidence and under enormous pressure, health personnel is forced to make use of off-label prescriptions, mostly repurposed drugs.

Moreover, to such conundrum is also added an unprecedented high rate of research articles published both in peer-review journals and in preprint servers. Thus, dynamic quality summaries are of paramount importance in order to inform governments, health authorities, health personnel and patients.

Methodology: Hence, this systematic review will compare treatment effectiveness in COVID-19 patients deducting from published data in the WHO COVID-19 Database and CDC COVID-19 Database.

Results and conclusions: After scrupulous reviewing and summarizing over 250 trials that enrolled over 100.000 patients, at this point in time effective and promising treatment are as follows: For non-severe patients casirivimab-imdevimab probably reduces hospitalisation, while bamlanivimab-etesevimab, and sotrovimab may reduce hospitalisation. Recently, also molnupiravir has been shown to be effective in reducing hospitalisation and mortality in phase III trials.

For severe patients, corticosteroids and interleukin-6 inhibitors offer important benefits, whereas EXO-CD24 and Janus kinase inhibitors appear highly promising, but the former is currently under the phase III trial, while the latter is still backed by low certainty evidence. Both tocilizumab and

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

sarilumab (IL-6 antagonists) and anakinra (IL-1 antagonist) have proven to be effective in different aspects, leading to WHO approval of IL-6 antagonists for COVID-19 patients.

On the other, a lack of effectiveness was shown for intravenous immunoglobulin, convalescent plasma, azithromycin, hydroxychloroquine, lopinavir-ritonavir, and interferon-beta, which were not able to confer important benefits. It is to date uncertain if remdesivir, ivermectin, or any other drugs are able to offer any benefit to COVID-19 patients, while unfavourable side effects are already documented, given their repurposed nature.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

SHËRBIMET FARMACEUTIKE DHE MASAT MBROJTËSE GJATË PANDEMISË NË FARMACITË KOMUNITARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Jeton Gutaj^{1}, Kaltrina Zenuni², Jehona Zogaj³*

^{1,3}Ministry of Health – Republic of Kosovo, Pharmaceutical Inspectorate,

²Alma Mater Europaea Campus College “Rezonanca”

jeton_gutaj@hotmail.com

Hyrje: Më 30 janar 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli emergjencën e shëndetit publik në përgjigje të pandemisë COVID-19 të shkaktuar nga një koronavirus i ri i quajtur sindroma e rëndë akute e frymëmarrjes koronavirus-2 (SARS-CoV-2). Sëmundja duket se ka origjinën nga një treg ushqimesh deti në Wuhan, ku kafshët e egra, duke përfshirë marmotat, zogjtë, lepujt, lakuriqët dhe gjarpërinjtë, tregtohen ilegalisht. Koronaviruset dihet se kalojnë nga kafshët te njerëzit, kështu që mendohet se njerëzit e parë të infektuar me këtë sëmundje - një grup i përbërë kryesisht nga mbajtës të tezgave nga tregu i ushqimeve të detit - e kontraktuan atë nga kontakti me kafshët. Më 13 mars 2020.

Qëllimi: Ky punim ka për qëllim të shikojë se qfarë masa mbrojtëse kanë marrë farmacistë në barnatore, gjendjen psikologjike, shqetësimi, vështërsitë si dhe ofrimi i shërbimeve farmaceutike gjatë pandemisë COVID19 nga farmacistët e komunitar në R.Kosovës. Metoda e hulumtimit: Ishte metodë kuantitative. Grupi i caktuar ishin Farmacistët/et (n=48) të anketuar të Republikës të Kosovës.

Rezultatet: 83.3% ka qenë farmacistë përgjegjës në barnatore, 68.8% farmaci të pa varura dhe 10.4% farmaci me rrjetë të madhë, 76.6% ose 50 receta në ditë janë egzekutuar, 91.7% kanë vërejtur se ka pasur rritje të fluksit të klientëve, 35.4% nuk kanë pasur problem me furnizim me barna dhe 36.9% mendojnë se mungesa e barnave krijon problem të mëdha, 10.4% janë ndjerë në ankth, 47.9% pak kanë qenë të shqetësuar, 31.3% e kanë kaluar ankthin me anë të bisedës, 59.6% bëjnë pyetje specifike për të përcaktuar nëse ata janë potencialisht me COVID-19, para se të shërbejnë pacientin 63.8% kanë deklaruar se sigurohen që distanca të jetë prej 2 metër, masat paraprake

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

të marra në nivel të Farmacisë 31.9% se egzistojnë politika dhe procedura specifike, 25.5% kanë ekran mbrojtës etj, masat paraprake të marra nga barnatorja 54.1% janë shumë të kënaqur, burimet e informacioneve rreth Covid-19 i kanë marrë 25.5% nga burimet elektronike, 56.3% e farmacistëve kanë dispenzuar grupet e barnave si: antibiotik, antiviral, analgjetik, 48.9% deklarojnë se nga grupi i antiviralëve është përshkruar Favipiravir, 57.4% janë përshkruar cefalosporinat, 47.8% kanë dispenzuar deksometazonin, 10.9% nuk rekomandohet kundër COVID-19, 66.7% i kanë dispenzuar të gjitha suplementët, 93.8% deklarojnë se antibiotikët janë dispenzuar më shumë gjatë COVID-19 se sa para COVID-19.

Fjalë kyçe: COVID-19, masat mbrojtëse, dhe shërbimet farmaceutike.

PHARMACEUTICAL SERVICES AND PROTECTIVE MEASURES DURING THE PANDEMIC IN COMMUNITY PHARMACIES IN THE R. OF KOSOVO

Jeton Gutaj^{1}, Kaltrina Zenuni², Jehona Zogaj³*

^{1,3}Ministry of Health – Republic of Kosovo, Pharmaceutical Inspectorate,

²Alma Mater Europaea Campus College “Rezonanca”

Introduction: On January 30, 2020, the World Health Organization declared a public health emergency in response to the COVID-19 pandemic caused by a new coronavirus called severe acute respiratory syndrome coronavirus-2 (SARS-CoV-2). The disease appears to have originated in a seafood market in Wuhan, where wild animals, including marmots, birds, rabbits, bats, and snakes, are traded illegally. Coronaviruses are known to pass from animals to humans, so it is thought that the first people infected with the disease—a group consisting mainly of stall holders from a seafood market—contracted it from contact with animals.

Purpose: This paper aims to see what protective measures have been taken by pharmacists in pharmacies, the psychological state, concerns, and difficulties, as well as the provision of pharmaceutical services during the COVID-19 pandemic by community pharmacists in the Republic of Kosovo.

Methodology: The research method was a quantitative one. The target group were pharmacists (n = 48) surveyed in the Republic of Kosovo. Results: 83.3% were responsible pharmacists in pharmacies, 68.8% were independent pharmacies, and 10.4% were pharmacies with a large network. 76.6%, or 50 prescriptions per day, were executed. 91.7% noticed that there was an increase in the flow of customers, 35.4% had not had a problem with the supply of drugs, and 36.9% thought that the lack of drugs created big problems. 10.4% were anxious, 47.9% were slightly concerned, 31.3% were able to overcome their anxiety through conversation, and 59.6% asked specific questions to figure out if they were potentially infected with COVID-19 before serving the patient. 63.8% stated that they make sure that the distance is 2 meters, with precautions taken at the pharmacy

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

level 31.9% believe that policies exist, and specific procedures are taken, 25.5% have a protective screen, etc., the precautions taken by the pharmacy 54.1% are very satisfied. The sources of information about COVID-19 have been obtained by 25.5% from electronic sources. 56.3% of pharmacists have dispensed drug groups such as: antibiotics, antivirals, analgesics; 48.9% declare that Favipiravir was prescribed from the group of antivirals; 57.4% were prescribed cephalosporins; 47.8% dispensed dexamethasone; 10.9% were not recommended for COVID-19; 66.7% dispensed all supplements; and 93.8% state that more antibiotics have been dispensed during COVID-19 than before COVID-19.

Keywords: COVID-19, protective measures and pharmaceutical services.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

NIVELET E D-DIMERIT TEK PACIENTËT E INFEKTUAR ME COVID-19. RASTE NGA LABORATORËT NË SHQIPËRI MIDIS NIVELEVE TË LARTA TË D-DIMERIT NË BOTË

***Joana KOLLÇAKU, **Dr. Shk Linda MATUA**

**Msc., Departamenti Farmacisë, Universiteti Mjekësisë, Tiranë*

***Departamenti Farmacisë, Universiteti Mjekësisë, Tiranë*

Hyrje: D-dimer është produkti më i vogël i degradimit specifik për fibrinolizën e gjendur në qarkullimin e gjakut, i përdorur shpesh për të matur dhe vlerësuar formimin e koagulimit të gjakut. Hepari prodhon disa proteina të rëndësishme të përfshira në koagulim, njëra prej të cilave përfshin fibrinogjenin. D-dimeri, një produkt i degradimit të fibrinës, paraqitet si një fragment i vogël i pranishëm në gjak i ndjekur nga koagulimi prej fibrinolizës. Përcaktimi i përqëndrimeve të D-dimerit është një test tepër i rëndësishëm në praktikën klinike për diagnostikimin e fenomeneve trombotike, embolive pulmonare si edhe problemeve të shkaktuara prej COVID-19. COVID-19 është një sëmundje infektive që shkakton sindromën respiratore akute severe (SARS-CoV-2) e përhapur për herë të parë në Wuhan, provincën Hubei në Kinë, në fundin e vitit 2019. Që prej këtij viti, përhapja në mënyrë masive thuhet në të gjithë vendet e botës, ka imponuar miratimin e masave të distancimit social, karantinimit dhe izolimit.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është identifikimi dhe vlerësimi i vlerave të D-dimerit tek pacientët e konfirmuar pozitivë me COVID-19, rëndësia e testit të D-dimerit, mënyrat e trajtimit dhe menaxhimit të rreziqeve të shfaqura.

Metodika: Lidhur informacioneve mbi rastet e pacientëve të ndryshëm në botë me problematikat e shkaktuara prej COVID-19, të dhënat prej studimeve dhe databazave të publikuara prej shteteve të ndryshme, kemi përzgjedhur rastet më me interes dhe në përputhje me objektivat mbi identifikimin dhe vlerësimin e vlerave të D-Dimerit tek pacientët pozitivë me COVID-19. Rezultatet e përfuara prej dy laboratoreve në qytetin e Tiranës, u bazuan mbi rishikim të të dhënave të rasteve të pacientëve që kishin kryer testimin, si dhe identifikimin e tyre përgjatë periudhave të caktuara kohore.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

Rezultatet: Rezultatet e përfuara prej dy laboratoreve mbi vlerat e D-Dimerit, respektivisht për periudhat INTERMEDICA- Shkurt 2020-Shkurt 2021 dhe BIO BEST ALBANIA- Tetor 2020-Shkurt 2021, janë vetëm një pasqyrë treguese dhe nuk japin informacion të detajuar për problemet shoqëruese të pacientëve. Në krahasim me studimet e tjera ndërkombetare, nivelet e D-dimerit lidhen me shënuesit inflamatorë të cilët tentojnë të normalizohen në fazën konvaleshente të shumicës së pacientëve.

Përfundime: Sëmundjet kryesore shoqëruese si hipertensioni, diabeti melitus, dislipidemia, obeziteti dhe historia familjare me probleme kardiovaskulare janë pikat kyçe të shfaqjes së problemeve të rënda COVID-19, ndërsa nga ana tjetër, shtatzënia është një gjendje hiperkoaguluese me rritje të ndjeshme fiziologjike të D-dimerit. Përdorimi i terapive antikoagulante me LMWH, terapitë antivirale, anti IL-6, antibiotikët, etj., kanë qenë disa nga linjat e para në trajtimin e pacientëve me nivele të larta të D-dimerit që ndikojnë në përmirësimin e menjëhershëm të simptomave.

Fjalët kyçe: D-dimer, COVID-19, koagulim, emboli pulmonare, trombozë e venave të thella, ishemi cerebrale.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

EFIKASITETI DHE SIGURIA E DEZINFEKTUESVE PËR DUART ME BAZË ALKOOLI NË PERIUDHEN E COVID-19

Silvi BOZO ^{1*}

Departamenti i Teknologjive Kimiko – Farmaceutike dhe Biomolekulare, Fakulteti i Farmacisë

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, Tiranë, Shqipëri

Eftiola POJANI ²

Departamenti i Vlerësimit Kimiko-Toksikologjik dhe Farmakologjik të Barnave, Fakulteti i Farmacisë Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, Tiranë, Shqipëri

Irsida MEHMETI ³

Departamenti i Shkencave Farmaceutike, Fakulteti i Farmacisë Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, Tiranë, Shqipëri

Hyrja dhe qëllimi: Gjatë pandemisë së Covid-19 e cila shkaktoi një krizë mjekësore botërore, higjienizimi i duhur i duarve morri një rol themelor si një nga strategjitë kryesore për të frenuar infektimet. Në fakt, ka pasur një kërkesë të konsiderueshme në rritje, veçanërisht lidhur me dezinfektuesit e duarve me bazë alkooli (ABHS), gjë që ka çuar, në disa periudha, në mangësi në ofertën e tyre nga tregu. Megjithatë aktiviteti antimikrobik i ABHS varet kryesisht nga përqendrimi i alkoolit, faktorë të tjerë si zgjedhja e formulimit mund të luajnë një rol në përcaktimin e efikasitetit. Nga ana tjetër, këto preparate mund të sjellin dëme në shëndetin e njeriut dhe mjedisin nëse nuk përdoren siç duhet. Ky studim hetoi efikasitetin e ABHS-ve të ndryshëm si dhe rreziqet e mundshme me qëllim për të dhënë rekomandime të dobishme për përdorimin e duhur kundër mikroorganizmave patogjenë edhe në epokën pas Covid.

Metodologjia: Ky studim është një rishikim literature e gjeneruar përmes një kërkimi të targetuar nëpërmjet fjalëve kyçe në databaza elektronike si Pubmed dhe Hinari për artikuj të publikuar në gjuhën angleze deri në Mars 2022.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

Rezultatet: Llojet e alkoolet më të zakonshme të përdorura në formulimet ABHS janë etanoli për aktivitetin e tij antiviral dhe izopropanoli kryesisht efektiv kundër bakteve. Disa organizata si

Administrata e Ushqimit dhe Barnave (FDA), Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) konfirmuan se përqendrimet e etanolit që variojnë midis 60% dhe 95% (v/v) janë të sigurta dhe efektive kundër viruseve, duke përfshirë SARSCoV- 2. Ndërkohë, rezultatet kanë treguar se përbërës të tjerë të përdorur në këto formulime, si lloji dhe përqindja e disa agjentëve xhelifikues dhe hidratantë mund të rrezikojnë efikasitetin e tyre. Për më tepër, megjithëse efikasiteti i ABHS duket të jetë i mirë dokumentuar, ka disa raportime për efekte

anësore lidhur me përdorimin e zgjatur, si toksiciteti sistemik dhe dermik, krahas gëlltimit aksidentale ose të qëllimshme.

Përfundimet: Dezinfektuesit e duarve konsiderohen si një nga asetet thelbësore për të parandaluar përhapjen e mikroorganizmave patogjenë dhe për të mbrojtur shëndetin publik. Në të njëjtën kohë, për të optimizuar efikasitetin dhe për të zvogëluar rreziqet, është e rëndësishme që këto

produkte të prodhohen, monitorohen dhe përdoren me kujdes nga konsumatori.

Fjalët kyçe: Covid-19, ABHS, etanol, higjiena e duarve.

EFFECTIVENESS AND SAFETY CONCERNS OF ALCOHOL-BASED HAND SANITIZERS IN THE COVID-19 ERA

Silvi BOZO , Eftiola POJANI, Irsida MEHMETI

Introduction: During the Covid-19 outbreak that involved a worldwide medical crisis, adequate hand hygiene assumed a fundamental role as one of the main strategies to contain the infection. In fact, there has been a significant growing demand especially related to alcohol-based hand sanitizers (ABHS) which has led, in some periods, to shortcomings in their offer. Although the antimicrobial activity of ABHSs is highly dependent on the alcohol concentration, other factors such as the choice of formulation can interplay a role in determining efficacy. On the other hand, these preparations can determine a harmful impact on human health and the environment if not handled properly. The present study investigated the efficacy of various ABHSs as well as their potential risks to provide useful recommendations for proper use against pathogenic microorganisms even in the post Covid era.

Materials and methods: This study is a literature review obtained through a keyword targeted search of different electronic databases such as Pubmed and Hinari for published articles in English up to March 2022.

Results: The most common used alcohols in ABHS formulations are ethanol for its virucidal activity and isopropanol mainly effective against bacteria. Several organizations such as the Food and

Drug Administration (FDA), Centers for Disease Control and Prevention (CDC), and the World Health Organization (WHO) confirmed that ethanol concentrations ranging between 60% and 95%

(v/v) are safe and virucidal, including SARS-CoV-2. In the meantime, results have shown that other ingredients used in these formulations, such as the type and percentage of gelling and emollient agents

may risk their efficacy. Furthermore, although the efficacy of ABHS seems to be well documented, there are several reports of adverse effects linked to their extended use such as systemic and dermal toxicity, besides accidental or intentional ingestion.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

Conclusions: Hand sanitizers are considered one of the crucial assets to prevent the spread of pathogenic microorganisms and safeguard the public health. At the same time, to optimize

effectiveness and reduce risks it is important that these products are carefully manufactured, monitored, and handled by the user.

Keywords: Covid-19, ABHS, ethanol, hand hygiene.

KIMIA E GJELBËR NË TRAJTIMIN E KOLLËS NË FËMIJËT ME COVID-19.

Kleva Shpati, Delina Xhafaj, Edlira Kaloshi, Aida Dama, Ergi Hoxha

Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore- Albanian University

Hyrje: Kolla ishte një nga simptomat më shqetësuese për pacientët pediatrikë me Covid-19 të trajtuar në shtëpi. Frika nga virusi, çon në përdorimin e barnave sintetike antitusive krahasuar me barnat me përmbajtje të ekstrakteve nga bimët mjekësore me veti të njohura antitusive. Viti pandemik i Covid-19 solli një qasje të re në përdorimin e bimëve mjekësore. Stigmatizimi i pacientëve me kollë mund të ndodhë, duke çuar në izolim social, veçanërisht gjatë infeksioneve me Covid-19. Identifikimi i mënyrave për të kontrolluar kollën e lidhur me Covid-19 mund të ndihmojë në parandalimin e transmetimit në komunitet dhe përhapjen e sëmundjes, si dhe në largimin e stigmës së kësaj simptome. Trajtimi me barna është gjithmonë në dilëmen midis efikasitetit dhe efekteve të padëshirueshme. Ndërsa tek të rriturit tolerohet gjithçka, tek fëmijët qasja është ndryshe ku efikasiteti duhet maskimal përkundrejt efekteve anësore minimale.

Qëllimi: Qëllimi i studimit tonë ishte njohja e trajtimeve të kollës për pacientët fëmijë me Covid-19 të trajtuar në shtëpi me simptoma të thjeshta dhe mesatarisht të moderuara. Sjelljet e komunitetit të farmacistëve dhe mjekëve për trajtimin e këtyre simptomave me preparatet Phyto.

Materiali dhe metoda: Ky është një studim i bazuar mbi të dhënat e mara nga një pyetsor i kryer në 10 farmaci të mëdha rrjeti në Tiranë si dhe në 3 klinikat kryesore ambulatorie të Tiranës gjatë vitit pandemik 2021 për periudhën Janar-Mars 2021 dhe Tetor - Dhjetor 2021. Ne mblodhëm informacione në lidhje me përdorimin e barnave antitusive. në këtë periudhë falë një pyetësori të shpërndarë për farmacistët dhe mjekët, i përbërë nga pyetje të hapura dhe të mbyllura. Pyetësori përfshin një kombinim të pyetjeve origjinale që përmbajnë të dhëna cilësore dhe sasiore. Pyetësori është vlerësuar nga një ekspert, i cili na rekomandoi të bëjmë dy lloj pyetjesh 1) me zgjedhje të shumëfishta dhe 2) pyetje të hapura, me fokus grup, ku pyetësori pëlosohej nga personeli kualifikuar si farmacistët dhe mjekët.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

Rezultatet: Nga gjithesej 240 pacientë, vetëm 195 (81.25%) u kanë dhënë përgjigje të cilat u raportuan si të sakta nga ana e farmacistëve dhe mjekëve. Të anketuarit , 99.2 % e tyre treguan se bimët mjekësore si antitusive ishin të preferuara në krahasim me alternativat e tjera, për shkak të efekteve të ulura anësore (perceptim jo profesional), por gjatë përdorimit të tyre në masën 87.8 %, përdornin barin antitusiv të rekomanduar nga mjeku, pavaresisht origjinës, për shkak të garantimit të efikasitetit. Sugjerimet e farmacistëve preferoheshin në masën 42% , megjithëse barnat ishin OTC. Pacientët përdornin në 76% në mënyrë të gabuar antitusivët në regjimin e dozimit ku binin në sy gabime rreth shpeshësisë dhe kohëzgjatjes. Nga të gjitha ekstraktet bimore të përdorura në formën e barnave fitoantiusive ishin ato me përmbajtjeje me Althea Officinalis me 66% e ndjekur nga Trumza 29% .

Përfundime: Si përfundim, duhet të rritet informacioni në komunitetin e mjekësve për të përdorur barnat e duhura fitoantiusive. Ekstraktet bimore të përftuara në forma farmaceutike nga bimët Althea officinalis dhe Thymus Vulgaris mund të tregojnë të njëjtin efikasitet krahasuar me barnat sintetike antitusive, por më pak efekte anësore. Ato duhet të njihen mirë përmes programit arsimor. Efektet anësore të bimëve mjekësore janë më të ulëta dhe ato mund të përdoren me efikasitetin e duhur që kanë dhe mund të përdoren më gjatë se ato sintetike. Shtimi i njohurive edhe për regjimin e dozimit përmirëson Praktikën e Mirë Klinike.

Fjale kyçe: Barna Fitoantiusive, Covid-19, Kollë, Regjim dozimi

GREEN CHEMISTRY AFFECT THE COUGH TREATMENT FOR COVID-19'S CHILDREN'S PATIENTS.

Kleva Shpati, Delina Xhafaj, Aida Dama , Edlira Kaloshi, Ergi Hoxha

Pharmacy Department, Faculty of Medical Science- Albanian University

Introduction: Cough was one of the most worrisome symptoms for pediatric patients with Covid-19 treated at home. The fear of the virus leads to the use of synthetic antitussive drugs compared to drugs containing extracts from medicinal plants with known antitussive properties. The pandemic year of Covid-19 brought a new approach to the use of medicinal plants. Stigmatization of cough patients can occur, leading to social isolation, especially during Covid-19 infections. Identifying ways to control cough associated with Covid-19 can help prevent community transmission and spread of the disease, as well as de-stigmatize this symptom. Drug treatment is always in the dilemma between efficacy and unwanted effects. While in adults everything is tolerated, in children the approach is different where the efficiency should be maximal against minimal side effects.

Aim: The aim of our study was to know the cough treatments for child patients with Covid-19 treated at home with simple and moderately moderate symptoms. Behaviors of the community of pharmacists and doctors for the treatment of these symptoms with Phyto preparations.

Material and method: This is a study based on data obtained from a questionnaire conducted in 10 large network pharmacies in Tirana as well as in 3 main outpatient clinics of Tirana during the pandemic year 2021 for the period January-March 2021 and October - December 2021. We collected information about the use of antitussive drugs. in this period thanks to a questionnaire distributed to pharmacists and doctors, consisting of open and closed questions. The questionnaire includes a combination of original questions containing qualitative and quantitative data. The questionnaire was evaluated by an expert, who recommended us to ask two types of questions 1) with multiple choices and 2) open questions, with a focus group, where the questionnaire was completed by qualified personnel such as pharmacists and doctors.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

Results: Out of a total of 240 patients, only 195 (81.25%) gave answers that were reported as correct by pharmacists and doctors. Respondents, 99.2% of them indicated that medicinal plants as antitussives were preferred compared to other alternatives, due to reduced side effects (non-professional perception), but during their use, 87.8% used the antitussive herb recommended by the doctor, regardless of origin, due to the guarantee of efficiency. Pharmacists' suggestions were preferred by 42%, although the drugs were OTC. In 76% of patients, antitussives were used incorrectly in the dosing regimen, where errors about frequency and duration were noticeable. Of all plant extracts used in the form of phytoantitussive drugs, those containing *Althea Officinalis* were 66%, followed by Thyme 29%.

Conclusion: In conclusion information must be increased in the medical community to use appropriate phytoantitussive drugs. Herbal extracts obtained in pharmaceutical forms from the plants *Althea officinalis* and *Thymus Vulgaris* may show the same efficacy compared to synthetic antitussive drugs, but with fewer side effects. They should be well known through the educational program. The side effects of medicinal plants are lower and they can be used with the proper efficacy they have and can be used longer than synthetic ones. Increasing knowledge about dosing regimens also improves Good Clinical Practice.

Key words: Phytoantibiotics, Covid-19, Cough, Dosage regimen.

**MODELI DIETIK DHE REZULTATET SHËNDETËSORE
QASJA E DIETËS MESDHETARE NË KOSOVË**

Armend Aliaga^{1,3*}, Lindita Aliaga^{1,2,4}, Darinka Gjorgieva Ackova¹

¹Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Departamenti i Farmacisë, Universiteti “Goce Delçev” Shtip, Republika e Maqedonisë së Veriut

²Alma Mater Europaea Campus College “Rezonanca” Prishtinë, Republika e Kosovës

³Salvus Albania dhe Kosovo L.L.C. Kompani Farmaceutike

⁴Shkolla e Mesme Profesionale e Mjekësisë “Dr. Ali Sokoli” Prishtinë, Republika e Kosovës

Hyrja: Përkufizimet e Dietës Mesdhetare (DM) janë të ndryshme në burime të ndryshme dhe disa koncepte mbivendosen me modele të tjera diete me përfitime të njohura shëndetësore. Dieta mesdhetare tradicionale kryesisht reflekton modelin dietik me bazë bimore duke marrë parasysh konsumin e lartë të perimeve, frutave dhe arrave, bishtajore dhe drithërat (jo të përpunuara), konsum të ulët të mishit dhe produkteve të mishit dhe produkteve të qumështit. Dieta mesdhetare është e lidhur me një sërë përfitimesh shëndetësore, duke përfshirë rrezikun e reduktuar të vdekshmërisë dhe incidencën më të ulët të sëmundjeve kardiovaskulare, dhe në vitet e fundit ka hyrë me shpejtësi në literaturën mjekësore. Aderimi më i lartë në dietën mesdhetare është i lidhur me një rrezik më të ulët të obezitetit, një sërë sëmundjesh jo të transmetueshme (si diabeti, sëmundjet kardiovaskulare, kanceri dhe sindroma metabolike), si dhe problemet mentale, sipas studimeve të publikuara akademike.

Por, edhe brenda rajonit euro-mesdhetar, vëmendja ndaj dietës mesdhetare ndryshon nga njëri komb në tjetrin. Kosova, si pjesë e Ballkanit Perëndimor (që përfshin Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kroacinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë), është një vend kontinental, pa dalje në det, ku zakonet dietike (p.sh., aderimi në DM) dhe lidhja me stilin e jetës dhe gjendja shëndetësore nuk është studiuar ende, ka mungesë

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

të të dhënave ose përgjithësisht konsiderohet vetëm në anketat e shumë vendeve.

Qëllimi: A tregon, studimi aktual synimin tonë për të vlerësuar aderimin në DM dhe ndikimin e tij në stilin e jetës, aktivitetin fizik dhe rezultatin shëndetësor në mesin e banorëve nga zona të ndryshme të Kosovës, me qëllimin kryesor për të vlerësuar se si qëndrueshmëria e DM është e lidhur në rrethana të ndryshme me mjedisin, ekonominë, socio-kulturorë dhe problematikat e të ushqyerit-shëndetit. Rezultatet: Të dhënat paraprake nga studimi në vazhdim, tregojnë rezultate të ulëta deri në mesatare të aderimit në DM dhe se nevojiten më shumë strategji goditëse për ta bërë qasjen e DM më të njohur për njerëzit duke adresuar rezultatet shëndetësore.

Fjalët kyçe: Dieta Mesdhetare, Modeli Dietik, Mënyra e Jetesës, Shëndeti.

**DIETARY PATTERN AND HEALTH OUTCOMES
- MEDITERRANEAN DIET APPROACH IN KOSOVO**

Armend Aliaga^{1,3}, Lindita Aliaga^{1,2,4},
Darinka Gjorgieva Ackova¹*

Introduction: Definitions of the Mediterranean diet (MD) are divergent in different sources, and some concepts are overlapping with other dietary patterns with known health benefit. The traditional MD mainly reflect plant-based dietary pattern considering high consumption of vegetables, fruits and nuts, legumes, and cereals (not processed), low consumption of meat and meat products, and dairy products. The Mediterranean diet has been linked to a number of health benefits, including reduced mortality risk and lower incidence of cardiovascular disease, and in the last years entered the medical literature rapidly. Higher adherence to the Mediterranean diet is linked to a lower risk of obesity, a variety of noncommunicable diseases (such as diabetes, cardiovascular disease, cancer, and metabolic syndrome), as well as mental problems, according to the published academic researches. But, even within the Euro-Mediterranean region, attention to the Mediterranean diet varies from one nation to the next. Kosovo, as part of the Western Balkans (which include Albania, Bosnia and Herzegovina, Croatia, North Macedonia, Montenegro, and Serbia), is continental, land-locked country, where dietary habits (ex., adherence to MD) and connection with lifestyle and health status have not been studied yet, there are lack of data, or is generally considered only in multi-country surveys.

Purpose: Does, the present study shows our intention to evaluate adherence to MD and its impact on lifestyle, physical activity and health outcome among inhabitants from different areas of Kosovo, with main goal to assess how sustainability of the MD is linked in different circumstances with environment, economy, sociocultural, and nutrition-health issues.

Results: The preliminary data from the ongoing study, shows low to middle score of adherence to MD, and that more hard-working strategies are needed to make MD approach more familiar to the people while address health outcomes.

Keywords: Mediterranean Diet, Dietary Pattern, Lifestyle, Health.

VLERËSIMI I MAKRO DHE MIKRONUTRIENTËVE NË PJESË TË NDRYSHME TË SAMBUCUS NIGRA NGA KOSOVA

Bujar Qazimi^{1*}, Trajçe Stafilov², Katerina Bačeva-Andonovska³, Krsto Tašev⁴, Shpend Dragusha¹, Hyrije Koraqi¹, Arianit Jakupi¹, Valon Ejupi¹

¹Faculty of Pharmacy, UBT- Higher Education Institution, Lagjia Kalabria, 10000 Prishtina, Republic of Kosovo

²Institute of Chemistry, Faculty of Natural Sciences and Mathematics, University Ss. Cyril and Methodius, 1000 Skopje, North Macedonia

³Research Center for Environment and Materials, Macedonian Academy of Sciences and Arts, Bul. Krste Misirkov 2, 1000 Skopje, North Macedonia

⁴State Phytosanitary Laboratory, Bul. Aleksandar Makedonski bb, 1000 Skopje, North Macedonia

Hyrje: Krahasuar me produktet shtazore, bimët përfaqësojnë një burim shumë të rëndësishëm mineralesh për njerëzit, meqë përmbajnë pothuajse të gjitha mineralet e konsideruara si thelbësore për ushqimin e njeriut. Disa makro dhe mikro elementë janë përbërës të kockave dhe dhëmbëve, ndërsa shumica e mikroelementeve luajnë një rol kyç si një faktor strukturor, katalitik ose lidhës në shumë procese enzimatike.

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi ishte përcaktimi i përmbajtjes së mineraleve në lulen dhe gjethen e Sambucus nigra (shtogut) spontane. Metodologjia: Materiali bimor është mbledhur në njëmbëdhjetë lokalitete të ndryshme në Kosovë në maj dhe qershor të vitit 2021. Mostrat janë trajtuar në një sistem mikrovalor me metodën e digjestionit. 0,5 g mostra nga bimët u hodhën në tubin Teflon, ku u shtuan 7 ml HNO₃ dhe 2,5 ml H₂O₂. Përzierja lihet të reagojë për 10 min. Pastaj tubat e Teflonit u vendosën në sistemin e mikrovalës. Mineralet u përcaktuan me zbatimin e metodës së plazmës së çiftuar me iduksion- spektrometria e emisionit atomik (ICP-AES) dhe metodës së plazmës së çiftuar me induksion – spektrometria e masës (ICP-MS). Në lulet dhe gjethet e S. nigra spontane u përcaktuan gjithsej 25 elementë. Përqëndrimet e Al, B, Ba, Ca, Cr, Cu, Fe, K, Mg, Mn, Na, P, Sr, V dhe Zn në të gjitha mostrat e analizuara u përcaktuan nga ICP-AES, ndërsa

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

përqëndrimet e As, Bi, Cd, Co, Cs, Ga, Li, Ni, Pb dhe Rb u përcaktuan me metodën ICP-MS.

Rezultatet: Lulet dhe gjethet e shtogut përmbajnë minerale të rëndësishme, si Ca, K, Mg dhe P.

Përfundime: Sipas rezultateve të fituara, lulet dhe gjethet e *S. nigra* mund të ofrojnë një burim të ri premtues të mineraleve të nevojshme për dietën e njeriut, si dhe për aplikime tjera të ndryshme.

Fjalët kyçe: *Sambucus nigra*, lule, gjethe, përmbajtja minerale, ICP-AES, ICP-MS

ESTIMATION OF MACRO AND MICRONUTRIENTS IN DIFFERENT PARTS OF SAMBUCUS NIGRA FROM KOSOVO

Bujar Qazimi^{1*}, Trajče Stafilov², Katerina Bačeva-Andonovska³, Krsto Tašev⁴, Shpend Dragusha¹, Hyrije Koraqi¹, Arianit Jakupi¹, Valon Ejupi¹

¹Faculty of Pharmacy, UBT- Higher Education Institution, Lagjia Kalabria, 10000 Prishtina, Republic of Kosovo

²Institute of Chemistry, Faculty of Natural Sciences and Mathematics, University Ss. Cyril and Methodius, 1000 Skopje, North Macedonia

³Research Center for Environment and Materials, Macedonian Academy of Sciences and Arts, Bul. Krste Misirkov 2, 1000 Skopje, North Macedonia

⁴State Phytosanitary Laboratory, Bul. Aleksandar Makedonski bb, 1000 Skopje, North Macedonia

Introduction: Compared to animal products, plants represent a very important source of minerals for humans, as they contain almost all minerals considered essential for human nutrition. Some macro and micro elements are components of bones and teeth, while most microelements play a key role as a structural, catalytic, or binding factor in many enzymatic processes.

Purpose: The aim of this study was the determination of mineral content in the flower and leaf of spontaneous *Sambucus nigra* (elderberry).

Methodology: Plant material was collected in eleven different localities in Kosovo in May and June 2021. Samples were digested in a microwave system by the wet digestion method. 0.5 g plant samples were put in the Teflon tube, where 7 ml of HNO₃ and 2.5 ml of H₂O₂ were added. The mixture was left to react for 10 min. Then Teflon tubes were put in the microwave system. The minerals were determined by the application of inductively coupled plasma–atomic emission spectrometry (ICP-AES) and inductively coupled plasma–mass spectrometry (ICP-MS). A total of 25 elements were determined in flowers and leaves of spontaneous *S. nigra*. The concentrations of Al, B, Ba, Ca, Cr, Cu, Fe, K, Mg, Mn, Na, P, Sr, V, and Zn in all analyzed samples were determined by ICP-AES, while the concentrations

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

of As, Bi, Cd, Co, Cs, Ga, Li, Ni, Pb, and Rb were determined by ICP-MS method.

Results: Elderflowers and leaves contain important minerals, such as Ca, K, Mg, and P.

Conclusion: According to obtained results, *S. nigra* flowers and leaves could provide a new promising source of necessary minerals for the human diet as well as other various applications.

Keywords: *Sambucus nigra*, flower, leaf, mineral content, ICP-AES, ICP-MS

**QUMËSHTI I GJIRIT DHE PËRDORIMI I BARNAVE GJATË
USHQIMIT TË FËMIJËVE ME QUMËSHT GJIRI**

Fatos Kadesha¹, Diana Toma²

Qumështi është një produkt i lëngshëm me ngjyrë të bardhë, shije dhe erë karakteristike dhe prodhohet nga gjëndrat qumështore ose gjijtë e femrave gjitare pra si tek kafshët dhe tek njerëzit dhe është burimi i parë dhe më natyral për të ushqyer të porsalindur, përderisa i porsalinduri të jetë i aftë të marrë dhe digjestojë tipe të tjera të ushqimit dhe nuk është e mundur të gjendet një ushqim që të zërë 100% vendin e qumështit të gjirit të nënës. Meshkujt e të gjithë llojeve të gjitarëve gjithashtu kanë gjijë dhe janë pjesë e strukturave të tyre trupore, por nuk janë të aftë të prodhojnë qumësht. Femrat gjitare zakonisht e bejnë prodhimin e qumështit mbas lindjes dhe është një përzjerje e pa krahasueshme që shërben si burim ushqimor i shkëlqyeshëm që foshnjën e porsalindur dhe këtu nuk mund të lëmë pa e përmendur dhe rolin shumëfishtë të tij për mbrojtjen kundër infeksioneve dhe rritjen e shkallës të imunitetit në organizmin e fëmijës. Ushqimi me qumësht gjiri sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Akademisë Amerikane të Pediatriisë duhet ekskluzivisht dhe minimalisht të zgjasë gjashtë muaj, por mund të zgjasë edhe deri në dy vjet, në varësi të nënës dhe fëmijës, pra deri kur fëmija kalon në ushqime të zakonshëm. Ushqimi i bebes me qumësht gjiri ose siç quhet dhe periudha e laktacionit, gjatë javëve të para të jetës: fëmija kryen 8-12 thithje qumësht në ditë dhe kohëzgjatja e ushqimit ose thithjes të qumështit është 10-15 minuta dhe natyrisht frekuenca e thithjeve bie me rritjen e fëmijës. Ushqimi i fëmijës me qumësht gjiri direkt nga gjiri i nënës është rruga më e mirë dhe më e zakonshme, sepse afron shumë fëmijën me nënën dhe i bën mirë si nënës ashtu dhe fëmijës.

Përfundimisht është konkluduar se asnjë qumësht ose formulë komerciale nuk mund të krahasohet me qumështin e nënës. Çdo ditë zbulon dobi të reja që ka qumështi i nënës për fëmijën, pirja e të cilit bile për deri dy vitet e para të jetës sjell dobi shumë të mëdha, sepse ndihmon në asimilimin e lëndëve të rëndësishme për organizmin në rritje të të voglit dhe garantojnë rritje dhe zhvillim normal të tij.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

REFORMAT NË FUSHËN E INSPEKTIMEVE, E ARDHMJA E INSPEKTORATIT SHËNDETËSOR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Dr. Shaban Osmanaj, Zëvendësues i Detyrës së Kryeinspektorit Shëndetësor,

Zj. Elvira Shyti, Asistente Ekzekutive e Kryeinspektorit Shëndetësor.

Hyrja dhe Qëllimi: Në janar 2022, Kosova miratoi Ligjin Nr. 08/L-067 për Inspektimet. Ky ligj përcakton parimet e inspektimit, themelimin e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm, rregullat për organizimin e organeve inspektuese në kompetencë të administratës shtetërore dhe komunale si dhe përcaktimin e rregullave për koordinimin dhe procedurën e inspektimit (neni. 1). Ky ligj ka paraparë rregullimin e katër (4) fushave inspektuse si; inspektimet shëndetësore, farmaceutike sanitare dhe preparateve vitaminoze, dietale dhe kozmetike me veprim terapeutik, në Agjencinë e Inspektoratit Qendror të Shëndetësisë, në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Inspektorati Shëndetësor i Kosovës është partner profesional në sektorin e shëndetësisë, për të përmirësuar shëndetin dhe cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve, si dhe rritjen e përgjegjësisë publike të ofruesve të shërbimeve shëndetësore. Ky zotim arrihet duke zbatuar legjislacionin, duke aplikuar praktika të mira, duke këshilluar entet e shëndetit publik për legjislacionin shëndetësor, korrigjimin pasues të shkeljeve të legjislacionit shëndetësor, zbatimin e dënimeve administrative dhe gjobave në rastet e shkeljes së parimeve shëndetësore dhe mbrojtjen e shëndetit publik në Kosovë. Ky studim ofron një analizë të plotë të reformave të fundit të sjella në inspektoratin shëndetësor dhe përshkruan mundësitë e ardhshme për cilësinë e shërbimeve në sektorin shëndetësor të Kosovës.

Metodologjia: Studimi aplikon metodën krahasuese empirike duke ilustruar të dhënat e inspektoratit shëndetësor, duke përfshirë të dhënat e inspektimit, numrin e inspektorëve, rregullat e shkelura, vendimet e marra, rekomandimet e dhëna, mbylljet e subjekteve shëndetësore dhe vendosja e gjobave. Studimi fokusohet gjithashtu në të dhënat farmaceutike, shëndetësore dhe interpretimin legjislativ.

Rezultatet: Të dhënat janë marrë nga raportet vjetore kombëtare për inspektimin shëndetësor të Kosovës. Si bashkëautorë, ne kemi nxjerrë të dhënat

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

Methodology and results: This research focuses on gathering information, at different levels of local service, in the city of Tirana (public, private hospitals, polyclinics, clinics, dispensaries, etc.), on what equipment's are available, what services are offered in each of them, costs and other accompanying information, so that at the end of this study we can present, analyze and judge as precisely as possible, on the current situation in this field for our country, the positive and negative sides of this reality.

Keywords: medical devices, diagnostic instruments, diagnostic service, cost, patient, Tirana

PËRDORIMI I BENZODIAZEPINAVE NË SHQIPËRI PËRGJATË VITEVE 2015-2020

Joana Mihani^{1}, Suela Këlliçi¹*

¹Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Hyrja dhe qëllimi: Benzodiazepinat (BZD) janë një klasë barnash e përdorur për trajtimin e patologjive të ndryshme. Kudo në botë ka një shqetësim në rritje për keqpërdorimin dhe mbipërdorimin e tyre. Sipas protokolleve të fundit, përdorimi i BZD rekomandohet për periudha të shkurtra kohore, sepse ai mund të shoqërohet me tolerancë farmakologjike, varësi dhe sindromin e abstinencës nga BZD. Ka shumë pak studime që hulumtojnë përdorimin e BZD në Republikën e Shqipërisë (RSH). Qëllimi kryesor i këtij studimi është të evidentojë në terma sasiorë përdorimin e BZD.

Metodologjia: U realizua një studim retrospektiv për të evidentuar përdorimin e BZD. U përdor metodologjia ATC/DDD e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) për të llogaritur DDD e rimbursuar për çdo bar të grupit të BZD të përfshira në Listën e Barnave të Rimbursuara (LBR) përgjatë viteve 2015-2020, duke shfrytëzuar të dhënat zyrtare të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Parametri i përdorur për vlerësim është numri i DDD për 1000 banorë në ditë.

Rezultate: Konsumi i BZD në skemën e rimbursimit ka pësuar një rënie të ndjeshme përgjatë viteve. Viti me konsumin më të lartë ishte 2015 me 1,39 DDD/1000 banorë/ditë dhe me konsumin më të ulët 2018 me 0.61 DDD/1000 banorë/ditë. Për barnat e LBR, ky konsum përbën rreth 10% të konsumit total duke marrë parasysh edhe lëvizjet e barnave jashtë skemës së rimbursimit.

Përfundimet: Konsumi i BZD në RSH është relativisht i ulët dhe ka pësuar një ulje të vazhdueshme përgjatë periudhës së studimit. Studimi i faktorëve që lidhen me mundësinë për tu bërë i varur nga BZD, do të ndihmonte në marrjen e masave të posacme për të evituar këtë fenomen të padëshiruar.

Fjalët kyçe: Benzodiazepina, konsum, Shqipëri

**THE USE OF BENZODIAZEPINES IN ALBANIA DURING
THE YEARS 2015-2020**

Joana Mihani¹, Suela Kelliçi¹*

¹Faculty of Medicine, University of Medicine, Tirana

Background and aim of the study: Benzodiazepines (BZDs) are a class of drugs used to treat various pathologies. Everywhere in the world, there is a growing concern about their misuse and overuse. According to recent protocols, BZD use is recommended for short periods of time because it may be associated with pharmacological tolerance, dependence, and BZD withdrawal syndrome. There are very few studies investigating the use of BZD in the Republic of Albania (RSH). The main purpose of this study is to identify in quantitative terms the use of BZD.

Methodology: A retrospective study was conducted to evidence the use of BZD. The ATC/DDD methodology of the World Health Organization (WHO) was used to calculate the reimbursed DDD for each drug of the BZD group included in the List of Reimbursed Drugs (RDL) during the years 2015-2020, using the official data of Compulsory Health Care Insurance Fund. The parameter used for evaluation is the number of DDD per 1000 inhabitants per day.

Results: BZD consumption in the reimbursement scheme decreased over the years. The year with the highest consumption was 2015 with 1.39 DDD/1000 inhabitants/day and the lowest consumption was 2018 with 0.61 DDD/1000 inhabitants/day. For RDL drugs, this consumption constitutes about 10% of the total consumption, taking into account the movement of drugs outside the reimbursement scheme.

Conclusions: BZD consumption in RSH is relatively low and has undergone a continuous decrease throughout the study period. Studying the factors related to the possibility of becoming addicted to BZD would help to take special measures to avoid this unwanted phenomenon.

Key words: Benzodiazepines, consumption, Albania

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

ÇFARË ËSHTË PMP (PRAKTIKA E MIRË E PRODHIMIT) DHE KRAHASIMI I PMP-SË ME UDHËZIMET E OBSH-SË?

Msc Jonida Hajderaj- Farmaciste, Drejtuese teknike në Prodhim

Prof. As. Edi Grabocka

Hyrja: Praktika e mirë e prodhimit është baza e çdo prodhimi farmaceutik në mënyrë që një produkt i prodhuar të përmbajë sasinë e duhur të përbërësve për efektin terapeutik të synuar.

Qëllimi: Ky punim ka për qëllim të përcaktojë se çfarë është PMP (Praktika e Mirë e Prodhimit) dhe siguron një krahasim midis PMP -së të BE -së me udhëzimet e OBSH për PMP.

Ky studim supozohet të krahasojë fokusin e inspektimit të PMP të BE -së dhe të WHO GMP udhëzime dhe të përpunojë dallimet, veçanërisht në lidhje me pyetjen se cili udhëzues i GMP përmban kërkesat më të rrepta dhe më të shtrenjta dhe në cilat seksione.

Metodologjia: Metoda e përdorur për përgatitjen e këtij studimi është përmes rishikimeve të literaturave të përdorura. Baza e të dhënave kryesore shkencore e përdorur për zgjedhjen e literaturës janë Biblioteka Conchrane, PubMed, Zlibrary, etj. Së pari, kriteret e përzgjedhjes u përcaktuan, dhe pastaj fjalët kyçe për të bërë kërkimin duke marrë parasysh kriteret e përzgjedhjes.

Rezultatet: Rezultati kryesor i hulumtimit është përmbledhja e parimeve kryesore të PMP në mënyrë që të Përbushë kriteret e PMP -së dhe të japë një krahasim të pranueshëm midis PMP të BE -së me udhëzimet e OBSH për PMP.

Diskutimi dhe përfundimet: Analizat kanë treguar se Praktikrat e Mira të Prodhimit janë thelbësore për prodhimin e çdo suplementi dietik, pajisje mjekësore ose produkti mjekësor të destinuar për përdorim njerëzor. Ka shumë interpretime të GMP-ve, të cilat mund të ndryshojnë shumë nga vendi në vend, por të gjitha udhëzimet e pajtueshmërisë ndjekin disa parime bazë. Për prodhuesit e barnave, Udhëzimi i OBSH -së dhe Eudral-ex kanë përshkruar skemën e përgjithshme të mëposhtme të sistemeve që

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

ndikojnë në prodhimin e ilaçeve dhe produkteve të barnave; 1-Organizimi dhe Personeli (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë & Pozicionet kryesore, Trajnimi dhe Zhvillimi) 2-Ndërtimi dhe objektet (zonat e pastra) 3-Pajisjet (vlefshmëria, kualifikimi, mirëmbajtja dhe regjistrimi i të dhënave) 4-Dokumentacioni (Alcoa, Menaxhimi i Ciklit të Jetës së Dokumenteve) Sa i përket krahasimit midis midis udhëzimeve të OBSH dhe Eu- PMP, objekt i këtij studimi është të analizojë harmonizimin midis tyre. Puna me udhëzimet e ndryshme gjatë këtij studimi tregoi harmonizimin e tyre në raportin

90%. Dallimi kryesor është se inspektimi i BE-së është më i fokusuar në inspektimin e godinës dhe ambjenteve të prodhimit, ndërkohë që inspektimi i FDA-së është i fokusuar në cilësinë e produktit.

Fjalët kyçe: PMP (Praktika e mirë e prodhimit), SC (Sigurimi i Cilësisë), Eudralex, KC(Kontrolli i Cilësisë); Udhëzimet e OBSH; Dhomat e pastra , PSP (Procedurë Standarte Pune), Formulatat Master të serive.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

WHAT IS GMP AND THE COMPARISON OF EU GMP WITH WHO GUIDELINES?

Msc Jonida Hajderaj - Pharmacist, Technical Director in Production

Prof. As. Edi Grabocka

Introduction: Good manufacturing practice is the basis of every pharmaceutical production so that a manufactured product contains the right amount of ingredients for the intended therapeutic effect.

Aims: This paper defines what GMP is and provides a comparison between EU GMP with WHO Guidelines for GMP.

This study is supposed to compare the focus of EU GMP inspection and WHO GMP guidelines and work out the differences especially with regard to the question which GMP guideline contains the stricter and more expensive requirements and in which sections.

Methods: The method used for the preparation of this study is through reviews of the used literature. The main scientific databases used for literature selection are Conchrane library, Pubmed, Zlibrary, etc. First, the selection criteria were defined, and then key words to do the search taking into account the selection criteria.

Results: The main research result is the summarizing of the main principles of the GMP in order to fulfill GMP Compliance and to give a reasonable comparison between EU GMP with WHO Guidelines for GMP.

Discussion and conclusions: The analyses have shown that Good Manufacturing Practices is essential for manufacturing any dietary supplement, medical device or drug product intended for human use. There are many interpretations of GMPs, which can vary widely from country to country, but all compliance guidelines follow a few basic principles. For drug firms, WHO guideline and Eudralex have outlined the following general scheme of systems that impact the manufacture of drugs and drug products; 1-Organization and personnel (QMS & Key People training and development) 2--Building and facilities (cleanroom area) 3-Equipment (Validation, Qual-

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

ification, Maintenance & Records) 4-Documentation (ALCOA, document life cycle management) Regarding the comparison between EU GMP and WHO GMP guidelines the object of this study was to analyse the harmonisation between them. Working with the different guidelines during this study showed their harmonisation to

90%. Great differences with regard to the requirements addressed to the pharmaceutical companies could not be detected. The main difference is that EU the inspection is more focus on the inspection of the facility and environment for the production area meanwhile the FDA inspection is focused on the quality of the product.

Key words: GMP (current good manufacturing practice), QA (Quality assurance), Eudralex, QC WHO guideline; (Quality Control), Clean rooms , SOP (Standard operating procedures), MBR (Master batch records)

KOMBINIMET TERAPEUTIKE NË ÇRREGULLIMET PSIKI- ATRIKE, NJË STUDIM DESKRIPTIV- RETROSPEKTIV NË QYTETIN E KORÇËS

Msc. Maria Koroveshi, Dr.Shk. Linda Matua¹*

¹ Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë Tiranë

Qëllimi: Qëllimi i studimit është vlerësimi i kombinimeve terapeutike të barnave që përdoren më shpesh për trajtimin e çrregullimeve psikiatrike si dhe vlerësimi i sigurisë dhe tolerabilitetit të tyre duke i krahasuar me monoterapinë.

Metodologjia: Studimi është deskriptiv retrospektiv me komponent analitik. U përfshinë në studim 83 pacientë që kanë marrë trajtim 5 vitet e fundit për një çrregullim psikiatrik pranë dy Qendrave Shëndetësore në qytetin e Korçës. U përpunuan të dhënat e grumbulluara nga kartelat mjekësore të pacientëve në tre lagje të ndryshme. U përcaktuan kriteret e përfshirjes dhe ata të përjashtimit nga studimi. Për qëllime studimi, pacientët u kategorizuan në grupe: sipas moshës, mënyrës së trajtimit, sipas llojit të kombinimit terapeutik të administruar, dhe sipas vizitave të kryera tek mjekët specialistë.

Rezultatet: Nga 83 pacientë të tre lagjeve të ndryshme që kanë marrë mjekim për një çrregullim psikiatrik pranë dy Qendrave Shëndetësore, 46 prej tyre ishin meshkuj dhe 37 femra. Diagnoza më e shpeshtë ishte çrregullimi psikotik. Barnat më të përdorura ishin antipsikotikët, të ndjekur nga antidepressivët, stabilizuesit e humorit dhe në fund anksiolitikët. Vetëm 18 prej pacientëve kishin marrë vetëm 1 bar psikotrop në monoterapi, kurse 65 prej tyre janë trajtuar me 2 ose më shumë barna psikotropë për një periudhë më të gjatë se 3 muaj. Nga krahasimi i efekteve anësore, u vu re se nga pacientët që janë trajtuar me politerapi 10,77 % e tyre janë ankuar për aritmi, 9,23 % për konstipacion, 13,85 % për çrregullim shikimi dhe 16,92 % për çrregullim gjumi. Kurse nga pacientët me monoterapi: 5,56 % janë ankuar për aritmi, 5,56% për konstipacion, 11,11% për çrregullime shikimi dhe 11,11 % për çrregullim gjumi. Ndryshimi është statistikisht domethënës.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

Gjithashtu, u konstatua se 25 % e pacientëve që janë trajtuar me 2 barna antipsikotikë, kanë marrë trajtim edhe me një bar antikolinergjik për shkak të efekteve ekstrapiramidale të shfaqura. Nga pacientët me monoterapi, kjo përqindje rezultoi 11,11%. Nga 83 pacientë që janë trajtuar për çrregullime psikiatrike, 25 prej tyre kanë kryer kontroll tek kardiologu, 16 tek okulisti dhe 8 pacientë tek endokrinologu.

Përfundimet: Pasi u analizuan në retrospektivë të dhënat për këta pacientë, u konfirmua administrimi i dy ose më shumë barnave psikotropë njëkohësisht tek i njëjti pacient si një faktor risku për shtimin e efekteve anësore. U vu re se trajtimi me më shumë se një bar antipsikotik shoqërohet me shtim të mundësive për shfaqjen e efekteve ekstrapiramidale.

Fjalët kyçe: çrregullim psikiatrik, barna psikotropë, politerapi, monoterapi.

**THERAPEUTIC COMBINATIONS IN PSYCHIATRIC
DISORDERS, A DESCRIPTIVE-RETROSPECTIVE STUDY IN
KORÇË, ALBANIA**

Msc. Maria Koroveshi, Dr.Shk. Linda Matua¹*

*¹ Department of Pharmacy, Faculty of Medicine, University of Medicine
Tirana*

Aim: The aim of this study is to evaluate the therapeutic combinations of the drugs most commonly used to treat psychiatric disorders, as well as to evaluate their safety and tolerability by comparing them to monotherapy.

Materials and methods: This is a retrospective descriptive study with analytical component. The study included 83 patients who have received treatment in the last 5 years for a psychiatric disorder at two Health Centers of Korça city. The data collected from the medical records of patients in three different neighborhoods were processed. Criteria for inclusion and exclusion from the study were defined. For study purposes, patients were categorized into groups: by age, by method of treatment, by the type of therapeutic combination administered, and by visits to specialists.

Results: Out of 83 patients from three different neighborhoods who received treatment for a psychiatric disorder at two Health Centers, 46 of them were male and 37 female. The most common diagnosis was psychotic disorder. The most commonly used drugs were antipsychotics, followed by antidepressants, mood stabilizers and finally anxiolytics. Only 18 of the patients had received only 1 psychotropic drug in monotherapy, and 65 of them had been treated with 2 or more psychotropic drugs for longer than 3 months. From the comparison of side effects between patients treated with monotherapy and those with polytherapy, it was noted that 10.77 % of the patients treated with polytherapy complained of arrhythmia, 9.23 % of constipation, 13.85 % of visual disturbances and 16.92 % of sleep disorders. From the patients who were treated with monotherapy: 5.56 % complained of arrhythmia, 5.56 % of constipation, 11.11 % of visual disturbances and 11.11 % of sleep disorders. The difference is statistically significant. Also, it was found that 25 % of patients who were treated with 2

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

antipsychotic drugs, received a treatment with an anticholinergic drug due to the extrapyramidal effects shown. Of the patients treated with monotherapy, this percentage resulted 11.11 %. 25 of the patients who were treated for psychiatric disorders, have had a check-up at the cardiologist, 16 at the ophthalmologist and 8 patients at the endocrinologist.

Conclusion: After analyzing the data for these patients in retrospect, it was confirmed the administration of two or more psychotropic drugs simultaneously to the same patient was a risk factor for increased side effects. It was observed that the treatment with more than one antipsychotic drug is associated with increased chances of appearance of extrapyramidal effects.

Keywords: Psychiatric disorder, psychotropic drugs, polytherapy, monotherapy.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

ADERENCA TERAPEUTIKE SI FAKTOR I RËNDËSISHËM NË KRIJIMIN E BESUESHMËRISË DHE ZBATIMIT PRAKTIK TË MARRJES KORREKTE TË BARNAVE

MSc Drilon Gashi¹, Prof. Asoc. Zehadin Gashi²

Farmaci "Barkos", Prizren, Kosovë

Departamenti i Farmacisë, Universiteti "Rezonanca", Prishtinë

Hyrje: Një ndër faktorët e rëndësishëm të veprimit të dëshiruar të barnave është krijimi i besueshmërisë në marrjen e udhëzimeve për barnat dhe zbatimi praktik i këtyre udhëzimeve nga ana e pacientëve. Kjo paraqet bazën e kujdesit për shërbimin farmaceutik në barnatore.

Qëllimi: Ky studim ka për qëllim të analizojë aderencën terapeutike si faktor i rëndësishëm në krijimin e besueshmërisë dhe zbatimit praktik të marrjes korrekte të barnave.

Metodologjia: Për të analizuar këtë faktor të rëndësishëm të kujdesit farmaceutik, janë hulumtuar shërbimet që ofrohen në disa barnatore të Kosovës. Janë pyetur farmacistët dhe pacientët në lidhje me udhëzimet që kanë dhënë, që kanë marrë dhe mënyrën e zbatimit për secilin rast.

Rezultatet: Nga analiza e bërë, në shumicën e rasteve, gjatë dhënies së barnave, udhëzimet që ju jepen pacientëve, janë të shkurtra, pa ndonjë interes se a i ka kuptuar pacienti ato udhëzime dhe a ka krijuar besim të plotë në udhëzimet e dhëna për të zbatuar ato në praktikë. Si rrjedhojë, në praktikë, ka ndodhur që nga informacionet e shkurtra dhe jo të qarta, pacientët të marrin barnat në mënyrë të gabuar. Faktorë që kanë ndikuar janë mosbindja e pacientit për të marrë barnat në mënyrën e duhur, duke i dhënë udhëzimet e shkurtra në formë të shifrave numerike dhe vendit të përdorimit.

Përfundimet: Si përfundim, mund të themi se aderenca terapeutike në praktikën farmaceutike pothuajse mungon dhe shërbimet profesionale që ofrohen në barnatore janë të mangëta. Faktorë që ndikojnë janë mungesa e trajnimeve dhe krijimi i kulturës farmaceutike nga pacientët për të

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

kërkuar dhe dëgjuar nga farmacisti udhëzimet e nevojshme për të krijuar besueshmërinë dhe zbatimin e tyre në praktikë. Prandaj, rekomandojmë që organizata joqeveritare profesionale të farmacistëve në trajnimet dhe edukimin e vazhdueshëm profesional në programet e tyre të kenë sa më shumë tema me përmbajtje për shërbime të suksesshme farmaceutike, duke përfshirë tema të veçanta lidhur me rregullat e komunikimit në barnatore, siç është edhe aderenca terapeutike pjesë e këtij komunikimi.

Fjalë kyçe: aderenca terapeutike, besim, zbatim, shërbim farmaceutik.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

ROLI I MEDIAS NË PROMOVIMIN E SHËNDETIT, REKLAMI I BARNAVE DHE KRITERET QË DUHEN RESPEKTUAR

Freskida Miloti, Farmaciste / Gazetare

Studente e doktoraturës në Liverpool John Moores University

Hyrje: Shëndeti i çdo personi është një thesar i paçmuar, por ajo që thuhet për të nuk është gjithmonë e qartë apo e menduar mirë. Në Shqipëri është e ndaluar për këdo, popullariteti i të cilit mund të ndikojë në përdorimin e produkteve farmaceutike. Ka ende stacione televizive që reklamojnë produkte farmaceutike në kundërshtim të drejtpërdrejtë me këtë rregull. Përafërsisht 3 vite më parë, në Fletoren Zyrtare, konkretisht, më 17 janar 2019 u botua RREGULLORE “Për PUBLICITETI TË BARNAVE”, për zbatimin e saj u ngarkua Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Në këtë rregullore, ndër të tjera, thuhet se është e ndaluar që barnat të reklamohen nga persona popullariteti i të cilëve mund të ndikojë në përdorimin e drogës. UDHËR Nr. 25, datë 17.1.2019 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PUBLIKIMIN E BARNAVE” Bazuar në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 1, të nenit 55, të ligjit nr.105. datë 31.7.2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar. “Pacienti është në qendër të këtij rregulli, i cili duhet ndjekur me kujdes për të mos cenuar shëndetin e pacientit apo respektin e mjekut dhe farmacistit”.

Përfundime: Ne mund të ndërgjegjësojmë çdo ditë me fuqinë e medias dhe imazhit për të pasur një jetë cilësore dhe shëndet të mirë përmes stilit të jetesës, por jo në një fushë që nuk i përket artistëve apo kujtdo tjetër që sugjeron në mënyrë arbitrare përdorimin e produktit farmaceutik. Është e rëndësishme që farmacitë, mediat dhe institucionet të punojnë së bashku për të siguruar që reklamimi i produkteve farmaceutike të jetë i saktë dhe për të mbrojtur shëndetin publik. Ne kemi forma për të promovuar shëndetin që janë brenda mundësive tona për t'i bërë.

Fjalët kyçe: Barna, rregullore, media, ndërgjegjësim, personazhe publike

THE ROLE OF THE MEDIA IN HEALTH PROMOTION, DRUG ADVERTISING AND THE CRITERIA TO BE RESPECTED

Freskida Miloti

PHD students in Liverpool John Moores University

Pharmacist / Journalist

Introduction: Every person's health is a priceless treasure, but what is said about it isn't always clear or well-thought-out. In Albania, it is prohibited for anyone whose popularity can influence use pharmaceutical products. There are still television stations advertising pharmaceutical products in direct violation of this rule. Approximately 3 years ago, the REGULATION "FOR PUBLICITY OF MEDICINES" was published in the official gazette, namely, on January 17, 2019, and the National Agency of Medicines and Medical Devices was charged with its implementation. In this regulation, among others, it is stated that it is forbidden for drugs to be advertised by people whose popularity can influence the use of the drug. ORDER No. 25, dated 17.1.2019 FOR THE APPROVAL OF THE REGULATION "FOR THE PUBLICITY OF DRUGS" Based on Article 102, point 4 of the Constitution of the Republic of Albania and point 1, of Article 55, of Law No. 105, dated 31.7.2014, "On drugs and pharmaceutical service", amended. "The patient is at the center of this rule, which needs to be followed carefully so as not to hurt the patient's health or the respect of the doctor and pharmacist."

Conclusion: We may raise awareness every day with the power of media and image to have a quality life and good health through lifestyle, but not in a field that does not belong to artists or anybody else who arbitrarily suggests pharmaceutical product use. It is important for pharmacies, the media, and institutions to work together to make sure that advertising for pharmaceutical products is accurate and to protect public health. We have forms to promote health that are within our ability to do.

Key words: Drugs, regulation, media, awareness, public figures

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

DIXHITALIZIMI I FARMACISE, DHE SFIDAT E MARKETINGUT FARMACEUTIK ONLINE NË SHQIPËRI.

**Silvana Crroj , Farmaciste, Nobel Ilaç, Tiranë, Shqipëri*

Hyrja: Interneti kryesisht vitet e fundit ndryshoi ekonominë dhe shoqërinë. Ky ndryshim preku dhe kujdesin shëndetësor, web-i ofron shumë mundësi, por është edhe burim rreziqesh për pacientët, duke pasur parasysh kontrollin e dobët që behët mbi informacionin. ‘Dixhitalizimi’ tashmë është bërë pjesë e rëndësishme e përditshmërisë tonë, dhe të gjithë sektorët farmaceutik janë përshtatur me epokën dixhitale me një ritëm shumë të shpejtë.

Qëllimi: Ky punim paraqet strategjitë e tregut farmaceutik online në lidhje me politikat e promovimit, ofertës dhe çmimeve. Momenti më kompleks për një industri farmaceutike, është tregtimi i produktit përfundimtar. Kjo për shkak të konkurrencës së madhe aktive në nivel global. Hendeku legjislativ i krijuar nga mungesa e një rregullimi kombëtar të tregtisë elektronike lejon që produktet të ofrohen edhe për pacientët që përdorin barin pa u konsultuar me mjekun, farmacistin (ose kundër këshillës tyre).

Metodologjia: Ashtu si pothuajse në të gjitha kontekstet e tjera, marketingu po aplikohet edhe nga kompanitë farmaceutike, duke u fokusuar në përdorimin e mediave sociale, në përmbajtjen e nivelit të lartë të SEO dhe në përdorimin e figurave që ndikojnë në zgjedhjet e përdoruesve (i ashtuquajturit “Influencer”). Më shumë kompani farmaceutike po përdorin faqet e mediave sociale (facebook, instagram, tik-tok) ose faqet e tregtisë elektronike (website) si platformë marketingu. Kjo mundëson blerjen online të produkteve nga klientët/pacientet. Kështu gjithnjë e më shumë farmaci vendosin të kenë një faqe interneti me një dyqan online të bashkangjitur për të tregtuar produkte farmaceutike dhe parafarmaceutike, duke diversifikuar dhe rritur xhiron e tyre.

Rezultatet: Farmacitë ndryshojnë në shumëllojshmërinë e produkteve që kanë (marka të ndryshme, kozmetikë dhe jo vetëm), cilësinë e shërbimit, sasinë dhe objektivin e pacientit.

Nga ana tjetër, nuk duhet harruar se ky është një sektor me shumë kufizime në shitjet online përsa i përket produkteve që lidhen me shëndetin

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

dhe mjekësinë. Për shkak të këtyre kufizimeve, fushatat mund të kryhen vetëm për produkte që mund të blihen pa recetë (barnat OTC).

Perfundimi: Çelësi i rritjes në industrinë farmaceutike është i lidhur ngushtë me të kuptuarit e nevojave të konsumatorëve, krijimin dhe përmirësimin e produkteve.

Pasi të kemi sqaruar këtë pikë, le të shohim se cilat janë tendencat e marketingut farmaceutik online. Do të shohim se si tendencat e marketingut farmaceutik mund të përshtaten për të udhëhequr strategjinë drejt ndryshimeve të momentit.

Fjalët kyçe: Marketingu farmaceutik, marketingu dixhital, strategjitë e marketingut dixhital, mediat sociale.

DIGITIZATION OF PHARMACY, AND THE CHALLENGES OF ONLINE PHARMACEUTICAL MARKETING IN ALBANIA.

**Silvana Crroj, Pharmacist, Nobel Ilaç, Tirana, Albania*

Introduction: In recent years, the internet has changed the economy and society. This change also affected health care, the web offers many opportunities, but it is also a source of risks for patients, given the weak control over information. “Digitalization” has already become an important part of our daily life, and all pharmaceutical sectors have adapted to the digital age at a very fast pace.

Purpose: This paper presents online pharmaceutical market strategies related to promotion, supply and pricing policies. The most complex moment for a pharmaceutical industry is the marketing of the final product. This is due to the great active competition at the global level. The legislative gap created by the lack of a international e-commerce regulation allows products to be offered even to patients who use the drug without consulting a doctor, pharmacist (or against their advice).

Methodology: As in almost all other contexts, marketing is also being applied by pharmaceutical companies, focusing on the use of social media, on high-level SEO content and on the use of images that influence user choices (the so-called “ Influencer”). More pharmaceutical companies are using social media sites (facebook, instagram, tik-tok) or e-commerce sites (website) as a marketing platform. This enables the online purchase of products by customers/patients. Thus more and more pharmacies decide to have a website with an online store to market pharmaceutical and parapharmaceutical products, diversifying and increasing their turnover.

Results: Pharmacies differ in the variety of products they have (different brands, cosmetics and more), the quality of service, the quantity and the patient’s target.

On the other hand, it should not be forgotten that this is a sector with many restrictions on online sales in terms of products related to health and medicine. Due to these restrictions, campaigns can only be run for products that

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

can be purchased without a prescription (OTC drugs).

Conclusion: The key to growth in the pharmaceutical industry is closely related to understanding consumer needs, creating and improving products.

Having clarified this point, let's see what are the trends of online pharmaceutical marketing. We will see how pharmaceutical marketing trends can be adapted to guide the strategy towards the changes of the moment.

Keywords: Pharmaceutical Marketing, Digital Marketing, Digital Marketing Strategies, Social Media.

PËRCAKTIMI I RISKUT KARDIOVASKULAR - ROLI I FARMACISTIT

Dr. Albana Doko Banushi

Kardiologe, QSUT

Hyrja: Sëmundjet kardiovaskulare (SKV) janë shkaku kryesor i mortalitetit dhe i invaliditetit në botë. Sipas INTERHEART study, 90% e të gjitha infarkteve mund ti atribuohen faktorëve të modifikueshëm të riskut; duhanpirjes, dislipidemisë, hipertensionit, diabetit, obezitetit, dietës dhe zakoneve jo të shëndetshme, inaktivitetit fizik, konsumit të alkoolit dhe faktorëve psikosociale.

Metodologjia: Në udhërrëfyesit e Shoqatës Europiane të Kardiologjisë (ESC) të vitit 2016 u përdor algoritmi i vlerësimit të riskut koronar sistematik (SCORE) për të vlerësuar rrezikun 10 vjeçar nga SKV. Algoritmi i përmirësuar SCORE dhe SCORE 2 vlerëson rrezikun 10 vjeçar të një individi për vdekje dhe ngjarje jo fatale kardiovaskulare në persona në dukje të shëndetshëm të moshës 40-69 vjeç.

Rezultate: Roli i farmacistëve është shumë i rëndësishëm pasi ata janë porta e parë ku trokasin pacientët në shërbimin publik, ata janë më të frekuentuarit nga njerëzit e cdo moshe dhe cdo lloj shtrese sociale duke qënë në një pozicion ideal për parandalimin e sëmundjeve kardio-vaskulare si në parandalimin primar dhe atë sekondar. Për parandalimin sekondar në pacientët me SKV të njohura, farmacisti mund të ofrojë suportin e tij për të optimizuar terapinë për pacientët nëpërmjet zbatimit korrekt të terapisë së përshkruar nga specialisti si dhe forcimit të aderencës ndaj mjekimit.

Konkluzione: Parandalimi i sëmundjeve kardiovaskulare (SKV) duhet të përfshijë një ekip multidisiplinar të ekspertëve të shëndetit dhe gjithë komunitetit, të mbështetur nga organizma shtetërore dhe organizime jo-qeveritare me qëllim identifikimin e hershëm të faktorëve të rrezikut për vlerësimin e riskut kardiovaskular (KV) dhe përmirësimin e stilit të jetës.

Fjalë kyce: Faktorë risku, sëmundje kardiovaskulare, SCORE.

THE EVALUATION OF THE CARDIOVASCULAR RISK - PHARMACIST'S ROLE

Dr. Albana Doko Banushi Cardiologist, QSUT

Introduction: Cardiovascular diseases (CVD) are the leading cause of mortality and disability in the world. According to the INTERHEART study, 90% of all heart attacks can be attributed to modifiable risk factors: smoking, dyslipidemia, hypertension, diabetes, obesity, unhealthy diet and lifestyle, physical inactivity, alcohol consumption and psychosocial factors.

Methodology: According to the 2016 European Society of Cardiology (ESC) guidelines, the systemic coronary risk assessment (SCORE) algorithm was used to estimate the 10 -year risk of CVD. The improved SCORE and SCORE 2 algorithm estimate an individual's 10-year risk of death and non-fatal cardiovascular events in apparently healthy persons aged 40–69 years.

Results: The role of pharmacists is very important as they are the first door where patients knock in the public service, they are the most frequented by people of every age and every type of social class, being in an ideal position for the prevention of cardiovascular diseases as in primary and secondary prevention. For secondary prevention in patients with known CVD, the pharmacist can offer his support to optimize the therapy for the patients through the correct implementation of the therapy prescribed by the specialist as well as strengthening the adherence to the medication.

Conclusions: Cardiovascular disease (CVD) prevention should involve a multidisciplinary team of healthcare experts and the whole community, supported by government and non-governmental organizations in order to identify early risk factors for cardiovascular risk (CVD) and to contribute in the lifestyle improvement.

Key words: Risk factors, cardiovascular disease, SCORE.

SËMUNDJET AUTOIMUNE TË SISTEMIT NERVOR: FIZIOPATOLOGJIA, PARAQITJET KLINIKE DHE TRAJTIMI I TYRE

Prof. Asoc Altin Kuqo MD. Neurolog Sherbimi i Neurologjisë QSUNT*

Qëllimi: Në shumë sindroma neurologjike të cilat janë konsideruar si idiopatike, vitet e fundit po evidentohet prania e autoantitropave kundër strukturave të ndryshme qelizore të sistemit nervor, duke konfirmuar kështu një etiopatogjenezë autoimmune. Keto gjetje janë të rëndësishme pasi shumë sëmundje të cilat deri tani konsideroheshin të patrajtueshme sot nuk janë më të tilla.

Metoda: Hulumtim i literaturës mbi sëmundjet neurologjike autoimmune dhe trajtimin e tyre të personalizuar, si dhe trajtimet e reja në këtë fushë

Rezultatet: Sëmundjet Neurologjike që shkaktohen si pasojë e çrregullimeve të sistemit autoimun, zënë një vend të rëndësishëm në tërësinë e sëmundjeve të sistemit nervor. Edhe pse të rralla, incidenca dhe prevalenca e tyre vjen gjithmonë duke u rritur. Këto sëmundje prekin të gjitha moshat por në një numër të konsiderueshëm prekin moshat e reja dhe me një shkallë të lartë invaliditeti. Për këto arsye njohja dhe diagnostikimi i hershëm këtyre sëmundjeve si dhe trajtimi adekuat i tyre ndihmon në përmirësimin e cilësisë së jetës së këtyre pacientëve.

Sëmundjet autoimmune të Sistemit Nervor prekin çdo pjesë të tij, trurin, palcën e kurrizit (Sistemi Nervor Qëndror, SNQ), si dhe junksionin neuromuscular, muskujt skeletikë, nervat periferik (Sistemin Nervor Periferik, SNP). Në këtë grup sëmundjesh bëjnë pjesë: skleroza e shumëfishtë, myasthenia gravis, neuromyeliti optik, sindroma Guillain – Barré, polineuropatitë inflamatore autoimmune, shfaqjet neurologjike të sëmundjeve të shkaktuara nga prania e antitropave IgG4 dhe Iglon 5 etj. Encefalitet autoimmune, Epiilepsitë autoimmune, Demenca dhe Migrena.

Neurologjia autoimmune është një nënspecialitet i cili i dedikohet zbulimit të antitropave të shumtë të cilët targetojnë proteina të shprehura në Sistemin Nervor. Këto zbulime ndihmuan në njohjen e autoimitetit si shkak i shumë sëmundjeve të cilat më herët keqdiagnostikoheshin si çrregullime psikiatrike, sëmundje degjenerative si demenca apo me shkak infeksioz.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

Përfundime: Zbulimet e fundit në shkaqet e këtyre sëmundjeve kanë çuar dhe në zbulimin barnave imunosupresore, përdorimi i të cilave ka sjellë një ndryshim pozitiv sinjifikant në përmirësimin e cilësisë së jetës së këtyre pacientëve të cilët vuajnë nga këto sëmundje deri dje të konsideruara të patrajtueshme.

Fjale kyçe: Neurologjia, autimuniteti, Sistemi Nervor Qendror, trajtimi imunosupresiv.

AUTOIMMUNE DISORDERS OF THE NERVOUS SYSTEM: PATHOPHYSIOLOGY, CLINICAL FEATURES, AND THERAPY

Prof. Asoc Altin Kuqo MD. Neurolog Sherbimi i Neurologjisë QSUNT*

Purpose: In many neurological syndromes which are considered idiopathic, in recent years the presence of autoantibodies against different cellular structures of the nervous system has been evidenced, thus confirming an autoimmune etiopathogenesis. These findings are important because many diseases that were considered untreatable today are no longer so.

Method: Literature research on autoimmune neurological diseases and their personalized treatment, as well as new treatments in this field

Result: Neurological diseases that are caused as a result of disorders of the autoimmune system, occupy an important place in the totality of diseases of the nervous system. Although rare, their incidence and prevalence is always increasing. These diseases affect all ages, but in a significant number they affect young peoples and with a high degree of disability. For these reasons, the early recognition and diagnosis of these diseases as well as their adequate treatment helps to improve the quality of life of these patients.

Autoimmune diseases of the Nervous System affect every part of it, the brain, the spinal cord (Central Nervous System, CNS), as well as the neuromuscular junction, skeletal muscles, peripheral nerves (Peripheral Nervous System, PNS). This group of diseases includes: multiple sclerosis, myasthenia gravis, optic neuromyelitis, Guillain-Barré syndrome, autoimmune inflammatory polyneuropathies, neurological manifestations of diseases caused by the presence of IgG4 and IgLON 5 antibodies, etc. Autoimmune Encephalitis, Autoimmune Epilepsies, Dementia and Migraine.

Autoimmune neurology is a subspecialty dedicated to the discovery of multiple antibodies that target proteins expressed in the Nervous System. These discoveries helped to recognize autoimmunity as the cause of many diseases that were previously misdiagnosed as psychiatric disorders, degenerative diseases such as dementia or infectious.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

Conclusion: The recent discoveries in the causes of these diseases have also led to the discovery of immunosuppressive drugs, the use of which has brought a significant positive change in improving the quality of life of these patients who suffer from these diseases, until nowadays considered untreatable.

Key words: Neurology, autoimmunity, Central Nervous System, immunosuppressive treatment.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

SINDROMI INFLAMATOR MULTISISTEMIK

*Ervin Rapushi, Artur Zoto, Teuta Backa,
Anastasio Kolasi*

*Departamenti i Semundjeve te brendeshme, Sherbimi Reumatologjise
QSUNT*

Sindromi inflamator multisistemik(SIM), eshte nje komplikacion i rralle qe shkaktohet post nje infeksioni viral, bakterial apo ne terren te nje semundje sistemike autoimune me aktivitet. Komplikacion shume i rralle qe u be evident me teper pas infeksionit nga COVID-19. Karakteristikat klinike me te shpeshta qe tregon se pacienti po shkon drejte SIM jane: temperatura, astenia, crregullimi i hemodinamikes, perfshirje te SCV, respirator, GI, SNQ etj. SIM imiton shume nje gjendje septike. Markerat inflamatore paraqiten te rritur gjate SIM: CRP, Ferritinemia, IL-1, IL-6, TNFa, LDH, D-dimer, PBNP, troponina, testet e koagulimit. Ne disa SIM mund te gjendet nje citokin inflamatore e rritur apo me shume se nje, kjo e varur edhe nga shkaktari i SIM.

Trajtimi i SIM eshte i varur nga etiologjia baze por ne vija te pergjitheshme bazohet ne perdorimin e antibiotikeve, antiviraleve, GK, heparines, target terapi ndaj citokinave inflamatore(Anakinra, Tocilizumab, Infliximab) si edhe medikamenteve te tjera suportuese te sistemeve te perfshira ne kete sindrom.

Fjale kyce: SIM, citokina, target terapi

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

HIPERTENSIONI SI FAKTOR I RËNDËSISHEM RRISKU NË PROGRESIN E SËMUNDJEN RENALE KRONIKE.

Dr Merita Rroji PhD

Lektor në Universitetin e Mjekësisë Tiranë.

Nefrolog në Shërbimin e Nefrologjisë QSUTN.

Sëmundja kronike e veshkave (SRK) është një nga problemet kryesore të shëndetit publik që prek miliona gra dhe burra në mbarë botën, e përcaktuar si dëmtim i vazhdueshëm i veshkave i shoqëruar nga një ulje e shkallës së filtrimit glomerular (GFR) dhe prania e albuminurisë. HTN është raportuar të ndodhë në 85% deri në 95% të pacientëve me SRK (fazat 3-5). Marrëdhënia midis HTN dhe SRK është ciklike, e identifikuar si një faktor rreziku vendimtar për zhvillimin e SRK, përparimin në fazën e fundit të sëmundjes renale (ESRD), sëmundjet kardiovaskulare (CVD) dhe vdekshmërinë. Prandaj, disa udhëzime rekomandojnë zbulimin dhe trajtimin e hershëm të HTN për të vonuar përparimin e sëmundjes dhe për të zvogëluar komplikimet e saj.

Marrëdhënia e ndërsjellë e SRK dhe HTN thekson më tej rëndësinë e arritjes së kontrollit të BP dhe uljes së proteinurisë, nëse është e pranishme. Agjentët që reduktojnë proteinurinë përveç presionit të gjakut janë përgjithësisht linja e parë. Bazuar në gjetjet, udhëzimet rekomandojnë terapinë me ACE frenues ose ARB si trajtim të linjës së parë për ata me diabet ose ata që paraqesin sëmundje jodiabetike të veshkave, HTN dhe proteinuri. Të dhënat tregojnë se frenuesit ACE dhe ARB janë po aq efektivë në uljen e presionit të gjakut dhe reduktimin e proteinurisë. Megjithatë, pacientët shpesh mund të kenë nevojë për tre deri në katër agjentë antihipertensivë për të arritur qëllimet e tyre dhe për të minimizuar rrezikun e tyre për CVD dhe ESRD. Për më tepër, modifikimet e një stili jetese të shëndetshëm duhet të konsiderohen gjithmonë një komponent jetik i çdo regjimi të terapisë antihipertensive.

HIGH BLOOD PRESSURE AND IMPORTANT RISK FACTOR IN CHRONIC KIDNEY DISEASE

Dr. Merita Rroji, PhD

Lector at University of Medicine Tirana; Nephrologist at University Nephrology Department "Mother Tereza", Tirane, Albania.

Chronic kidney disease (CKD) is one of the leading public health problems affecting millions of women and men worldwide, defined as persistent kidney damage accompanied by a reduction in the glomerular filtration rate (GFR) and the presence of albuminuria. HTN has been reported to occur in 85% to 95% of patients with CKD (stages 3-5). The relationship between HTN and CKD is cyclic, identified as a crucial risk factor for CKD development, progression to end-stage renal disease (ESRD), cardiovascular disease (CVD), and mortality. Accordingly, several guidelines recommend early detection and treatment of HTN to delay the disease's progression and reduce its complications.

The interrelationship of CKD and HTN further emphasizes the importance of achieving BP control and decreasing proteinuria, if present. Agents that reduce proteinuria in addition to BP are generally the first line. Based on the findings, guidelines recommend ACE inhibitor or ARB therapy as first-line treatment for those with diabetes or those presenting with nondiabetic kidney disease, HTN, and proteinuria. Data indicate that ACE inhibitors and ARBs are equally effective in lowering BP and reducing proteinuria. However, patients may often require three to four antihypertensive agents in order to achieve their goals and minimize their risk for CVD and ESRD. In addition, healthy lifestyle modifications should always be considered a vital component of any antihypertensive therapy regimen.

ZBATIMI I UDHËRRËFYESVE PËR TRAJTIMIN E DISLIPIDEMIVE – ROLI I FARMACISTIT

*Mirald Gina, Shërbimi i Kardiologjisë I, Qendra Spitalore Universitare Tiranë**

Hyrja dhe qëllimi: Paraqitja dhe shpjegimi i udhërrëfyeseve të trajtimit të dislipidemive, me një fokus të veçantë në rolin e farmacistit si hallkë kyçe në implementimin dhe zbatimin e tyre

Metodologjia: Vështrim analitik mbi sëmundjet kardiovaskulare si pasojë e aterosklerozës së murit arterial dhe trombozës, shkak kryesor i mortalitetit të parakohshëm në Evropë. Parandalimi dhe trajtimi i dislipidemive janë pjesë thelbësore dhe integrale e programeve të parandalimit të sëmundshmërisë kardiovaskulare. Dislipidemitë mund të jenë sekondare, ose janë pasojë e ndërthurjes midis predispozitës gjenetike dhe mënyrës së jetesës. Rritja e kolesterolit total dhe lipoproteinave me densitet të ulët (LDL) janë ato që kanë fituar më tepër vëmendje, duke qenë se mund të modifikohen përmes ndryshimeve në mënyrën e jetesës dhe terapisë me barna. Të dhënat nga studime të mëdha të randomizuara se ulja e kolesterolit total dhe LDL mund të parandalojë sëmundjet kardiovaskulare janë të forta, ndaj këto përbëjnë objektivat kryesorë të trajtimit të dislipidemive.

Rezultatet: Pengesat kryesore të identifikuara në manaxhimin e lipideve janë mosaderenca me trajtimin (57.3%), doza suboptimale ose mos-titrimiti (31.7%), zgjedhja suboptimale e trajtimit (31.5%) dhe përdorimi i terapive të kombinuara që nuk tolerohen mirë nga pacientët (14.1%).³ Farmacistët mund të luftojnë këtë problem duke monitoruar përgjigjen ndaj mjekimit, duke u siguruar për dozimin optimal dhe duke sugjeruar ndryshimin apo përforsimin e terapisë kur përfitimi ka arritur një kurbë të sheshtë. Gjithashtu, farmacistët mund të ndihmojnë në thjeshtimin e regjimeve të trajtimit (psh terapi e kombinuar në një formulim), reduktimin e kostove të mjekimit përmes sugjerimit të opsioneve më ekonomike, monitorimin e pacientëve për aderencën ndaj mjekimit dhe piketimin e atyre pacientëve që kanë më tepër nevojë për edukim, duke përfshirë dhe familjen e tyre në arritjen e objektivave të trajtimit apo duke rritur shpeshhtësinë e takimeve me mjekun e familjes apo kardiologun.⁴ Gjithashtu, në përpjekje për të

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

shmangur efektet anësore të mjekimit, disa pacientë mund të përdorin formulime pa recetë që nuk janë efikase.

Përfundime: Farmacistët kanë shumë mundësi për të përmirësuar manaxhimin e dislipidemive, duke përfshirë identifikimin e pacientëve në risk që mund të përfitojnë nga terapia, sigurimin e fillimit të sigurt të terapisë, monitorimin e aderencës së pacientëve, përgjigjen ndaj terapisë dhe tolerimin e saj dhe sigurimin e edukimit në vazhdim për pacientët.

Fjalë kyç: dislipidemi, farmacisti, aderenca

APPLICATION OF DYSLIPIDEMIA TREATMENT GUIDELINES – THE ROLE OF THE PHARMACIST

*Mirald Gina, Cardiology Department, University Hospital Mother Teresa**

Introduction and purpose: Presentation and explanation of dyslipidemia treatment guidelines, with a special focus in the role of the pharmacist as a key link in their implementation.

Methodology: Analytical discussion on cardiovascular diseases as a result of atherosclerosis of the arterial wall and thrombosis, as a leading cause of premature mortality in Europe. Prevention and treatment of dyslipidemias are an essential and integral part of cardiovascular disease prevention programs. Dyslipidemias can be secondary, or the result of a combination of genetic predisposition and lifestyle. The increases in total cholesterol and low-density lipoproteins (LDL) are what have gained more attention, since they can be modified through changes in lifestyle and drug therapy. There are strong evidences from large randomized trials that lowering total cholesterol and LDL can prevent cardiovascular diseases, so these make up the main objectives of the treatment of dyslipidemias.

Results: The main obstacles identified in lipid management are non-adherence to treatment (57.3%), suboptimal dose or non-titration (31.7%), suboptimal choice of treatment (31.5%) and use of combined therapies that are not well tolerated by patients (14.1%)³. Pharmacists can combat this problem by monitoring response to medication, ensuring optimal dosing and suggesting change or intensification of therapy when benefit has plateaued. Also, pharmacists can help by simplifying treatment regimens (e.g. combined drugs in one pill), reducing medication costs by suggesting more economic options, monitoring patients for medication adherence and selecting those patients who need more education, including their families, in order to achieve the treatment goals, or by encouraging appointments with the family doctor or cardiologist.⁴ Also, trying to avoid the side effects of the medication, some patients can use over-the-counter formulations that are not effective, even harmful.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

Conclusions: Pharmacists have many opportunities to improve the management of dyslipidemias, by identifying patients at-risk who may benefit from therapy, ensuring safe initiation of therapy, monitoring patient adherence, response to therapy and its tolerability and providing a continuation of education for patients.

Key words: dyslipidemia, pharmacists, adherence.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

TRAJTIMI I INFEKSIONEVE URINARE NE EREN E REZISTENCES MIKROBIALE DHE AGJENTEVE TE RINJ ANTIMIKROBIALE.

Prof. Myftar Barbullushi

- *Shef i Sherbimit te Nef-Dial-Trans, QSU "N. Tereza"*
- *President i Shoqates Shqiptare te Nefrologjise*
- *President i Shoqates Ballkanike te Nefrologjise*
- *Anetar i Bordit Drejtues te Shoqates Europiane te Europes Jugore dhe Lindore per Shoqaten Boterore te Nefrologjise (ISN), FERA of Nephrology*

UTI-të mund të prekin këdo, por veçanërisht gratë. 80% e grave zhvillojnë një UTI, dhe rreth një e katërta e tyre kanë përsëritje të shpeshta. Shkaku i recidivave është i paqarte. Studimi i ri, i botuar më 2 maj 2022 në revistën Nature Microbiology, Are Antibiotics the Cause, Not Solution, of Recurrent UTIs? ofron prova bindese të një arsyeje të mundshme: Antibiotikët e përdorur për trajtimin e UTI-ve mund të krijojnë skenën për infeksione të përsëritura duke varfëruar mikrobiomën e zorrëve me bakterie të dobishme. Mikrobioma, grupi i baktereve që natyrshëm banojnë në trup, kryesisht në zorrë, ndihmon në funksionimin e organizmit -- duke përfshirë përgjigjen imune. Zorrët dihet gjithashtu se janë një "rezervuar" për disa baktere që shkaktojnë shumicën e UTI-ve - të ashtuquajturat E. coli uropatogjene. UTI-të shpesh lindin nga "ngjitja" e atyre baktereve nga zorrët në traktin urinar. Në teori, prishja e ekuilibrit delikat midis baktereve të zorrëve "të mira" dhe "të këqija" mund të predispozojë disa gra për UTI të përsëritura. Studimi zbuloi se gratë me UTI të përsëritura kishin një mikrobiomë të zorrëve me shumë më pak diversitet në bakteret e tyre të mira, dhe më pak mikrobe që prodhojnë butirate - një acid yndyror që ndihmon në kontrollin e inflamacionit. A ishte trajtimi me antibiotikë për UTI-në e parë qe prishi kete ekuilibër apo cregullimi i mikrobiomit të zorrëve, për arsye te ndryshme I kushtezoi gratë për rekurencën dhe antibiotiku vetem e përkeqësoi situatën ? Gjithsesi ky studim hedh ujë të ftohtë mbi nocionin tradicional se UTI-të e përsëritura janë një çështje "higjienë". Kjo nuk ka të bëjë me higjienën. Sigurisht që ka raste kur nevojitet një antibiotik, sidomos kur UTI shoqerohet me ethe. Një alternativë tjetër për UTI-të e përsëritura është një ilaç i quajtur methenaminë. Ajo funksionon duke e bërë urinën më acidike dhe duke ndaluar rritjen e baktereve, duke treguar

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

se parandalon UTI-të e përsëritura. Një tjetër opsion për disa gra, është estrogjeni vaginal. Estrogjeni vaginal mund të parandalojë UTI-të e përsëritura në disa gra. “Ne po përpiqemi të zhvillojmë komponime të reja për të varfëruar në mënyrë selektive E. coli uropatogjene, duke mbajtur të paprekur mikrobiomën e zorrëve,“ Në përbërës i tillë, i bazuar në manozidin e sheqerit, aktualisht është duke u testuar në një provë klinike.

Fjalët kyçe: Infeksione urinare, recidivante, rregullime hormonale, antibiotikoterapi

MEDICAL THERAPY FOR INFLAMMATORY BOWEL DISEASE

**S.Prifti1, M.Sina1, Xh.Pemaj1, A.Babameto1*

1University Clinic of Gastroenterology, University Hospital Center Mother Teresa, Albania

Introduction: Inflammatory bowel diseases (IBD) consists of two clinical entities, ulcerative colitis (UC) and Crohn's Disease (CD). These two diseases differ in localization (UC usually affects colon while CD can affect any segment of the gastrointestinal tract from the mouth to the anus", disease extension (continuous vs segmental), depth of inflammation (mucosal vs transmural), and histology (cryptic abscesses vs granulomas).

The goals of therapy are to induce and maintain remission, minimize disease-related complications and to improve patient's quality of life.

The main drugs used in the treatment of IBD are aminosalicylates, corticosteroids, immunomodulators and anti-TNF agents.

Aminosalicylates (sulfasalazine, mesalamine, olsalazine, balsalazide) are effective in treating mild-to-moderate IBD and useful as a maintenance treatment in preventing relapses of the disease. 5-ASA agents are available as oral or rectal preparations (suppositories, foams, enemas). Enemas can reach to the proximal part of the sigmoid and splenic flexure in almost all patients. In contrast, foamed 5-ASA generally reaches the mid-sigma; suppositories are effective only for the initial part of the rectum.

Corticosteroids (methylprednisolone, prednisone, hydrocortisone, budesonide) have a strong glucocorticoid effect and minimal mineralocorticoid effect. They are used to induce remission in patients with moderate to severely active IBD. The most preferred corticosteroids are prednisone and methylprednisolone. Topical glucocorticoids in liquid and foam formulations are effective short-term therapy for active IBD distal to the splenic flexure. Corticosteroids have significant short- and long-term side effects and are not used as a maintenance therapy.

Immunomodulators. This group of drugs includes antimetabolites (azathi-

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

oprine, 6-mercaptopurine, methotrexate) and calcineurin inhibitors (cyclosporine, tacrolimus). These preparations are used for steroid-resistant or dependent patients, or for early use in patients with moderate to severe initial presentation of the disease. Monotherapy with azathioprine or mercaptopurine is also used for the maintenance of remission in UC and CD.

Biologic therapy is the current mainstay of IBD therapy and is primarily based on monoclonal antibodies directed against specific molecules with immunomodulatory or inflammatory activity. anti TNF- α agents [Infliximab (IFX) and Adalimumab (ADA)] are indicated in the treatment of moderate and severe IBD, for induction and maintenance of clinical remission, healing of the mucosa, as well as eliminating the use of corticosteroids in patients who have had an insufficient response, or have contraindications for other conventional therapies.

ÇFARË KA MUNGUAR NË KUJDESI SHËNDETËSOR TË MJEKËSISË SHQIPTARE?

Dr. JOSIF RISTO^{1,2}, Msc. Jora Risto², Msc. Ela Bebeci¹

¹ Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Universiteti Luarasi Tiranë, Shqipëri

² Instituti i Mjekësisë Tradicionale Alternative dhe Plotësuese, IMTAP Tiranë, Shqipëri

Në vendin tonë, si në shumicën e vendeve të OBSH-së, kujdesi shëndetësor parësor është i bazuar vetëm në mjekësinë konvencionale, në disa prej tyre dominon Mjekësia Tradicionale, ndërkohë që në raportimet e OBSH-së shumë vende anëtare ofrojnë një mjekësi Gjithpërfshirëse. Kjo ka çuar këtë organizëm që të përpilojë një strategji (Strategjia e OBSH për mjekësinë Tradicionale 2014-2023), me qëllimin që të nxiten edhe vendet që nuk e ofrojnë këtë shërbim. Kujdesi primar shëndetësor i përqëndruar tek njerëzit, nëpërmjet disiplinave të Mjekësisë Alternative, ku bën pjesë edhe mjekësia tradicionale, ofron qasje holistike për shëndetin, që e bën parandalimin po aq të rëndësishëm sa edhe trajtimin e sëmundjeve. Si pjesë e kësaj qasjeje parandaluese, mjekët do të adresojnë siç duhet shkaqet rrënjësore të problemeve shëndetësore. Rritja e mjekësisë alternative është një mundësi/kërkim për kujdes shëndetësor më të personalizuar, më të gjërë dhe më të përzemërt/mëshirshëm. Njerëzit, duan që kujdesi shëndetësor parësor, të jetë me rezultate të mira shëndetësore, me kosto të ulët dhe të japë kënaqësinë maksimale të përdoruesit. Mjekësia Alternative ofron një kujdes shëndetësor gjithpërfshirës. - I barabartë për të gjitha shtresat dhe entitetet, i përballueshëm por edhe i efektshëm. - Trajtohet organizmi në tërësinë e tij. - Bashkëpunimi në trajtim (mjek – mjek dhe mjek – pacient) është më i pranishëm. Sipas OBSH-së, këto qëllime do të arrihen duke zbatuar tre objektiva strategjike: ndërtimin e bazës së njohurive dhe formulimin e politikave kombëtare; forcimin e sigurisë, cilësisë dhe efektivitetit përmes rregullimit; dhe promovimi i mbulimit universal shëndetësor duke integruar shërbimet e T&PM-së dhe vetë-kujdesin shëndetësor në sistemin shëndetësor kombëtar. Duhet të themi se pavarësisht rezultateve, qysh në fillim (2014), nuk ka munguar kontributi i IMTAP-së për rregullimin e kujdesin shëndetësor të vendit tonë, si nëpërmjet konsulencës profesionale dhe propagandimin e rëndësishëm të kësaj çështjeje.

Fjalë kyç: Strategji; mjekësi gjithpërfshirëse; Mjekësi alternative; siguri; efikasitet; Mjekësi tradicionale, plotësuese (T&PM); Instituti i mjekësisë tradicionale alter

WHAT HAS BEEN MISSING IN HEALTH CARE OF ALBANIAN MEDICINE?

Dr. JOSIF RISTO^{1,2}, Msc. Jora Risto², Msc. Ela Bebeci¹

¹ Faculty of Medical Sciences, Luarasi University, Tirana, Albania

² Institute of Traditional, Alternative and Complementary Medicine (IM-TAP), Tirana, Albania

In our country, as in most WHO countries, primary health care is based only on conventional medicine, in some of them Traditional Medicine dominates, while in WHO reports, many member countries offer Comprehensive medicine. This has led this organization to compile a strategy (WHO Strategy for Traditional Medicine 2014-2023), with the aim of encouraging countries that do not offer this service. Primary health care focused on people, through the disciplines of Alternative Medicine, which also includes traditional medicine, offers a holistic approach to health, which makes prevention as important as treating diseases. As part of this preventive approach, doctors will properly address the root causes of health problems. The rise of alternative medicine is an opportunity/quest for more personalized, comprehensive and compassionate health care. People want primary health care to provide good health outcomes, low cost and maximum user satisfaction. Alternative medicine offers comprehensive health care. - Equal for all layers and entities, affordable but also effective. - The organism is treated in its entirety. - Cooperation in treatment (doctor - doctor and doctor - patient) is more present. According to WHO, these goals will be achieved by implementing three strategic objectives: building the knowledge base and formulating national policies; strengthening safety, quality and effectiveness through regulation; and, promoting universal health coverage by integrating T&PM services and self-health care into the national health system. We must say that regardless of the results, since the beginning (2014), IMTAP contribution to the regulation and health care of our country has not been lacking, both through professional consultancy and the promotion of the importance of this issue.

Keywords: Strategy; comprehensive medicine; alternative medicine; security; efficiency; Traditional, complementary medicine (T&PM); Institute of traditional alternative and complementary medicine (IMTAP).

FARMACEUTIKA, ZHVILLIMI DHE ROLI SAJ TEK NJERIU

Fatos Kadesha¹, Diana Toma²

¹ *Antar i UFSH-se*

² *Presidente e UFSH*

Midis disa karakteristikave unike të njeriut, duke filluar që nga Homo Sapiens, është tendenca që të shërojë sëmundjet me barna, pra si rezultat i kësaj farmacia ka qenë pjesë e pa ndarë e historisë të njerzimit dhe përmbushte një nga nevojat më të domosdoshme të tij.

Në kohët e lashta, sëmundjen e shprehnin si një një ndëshkim të ZOTIT, për të këqiat apo mëkatet që ke kryer. Kështu që praktikuesi mjeksor i quajtur Shaman, kombizonte barna që të mjekonin apo largonin influencën e magjisë dhe të shpirtrave të këqij. Gjatë periudhës antike dhe me zhvillimin e shoqërisë, teoria supernatyrare mbi sëmundjet filloi të bjerë dhe zhvillimi i madh nëmijëvjeçarin e dytë në Mesopotami dhe Egjipt në mjeksi u pasqyrua me tabletat prej argjili dhe Papiruset dhe formulari më i hershëm është ai samerian rreth 2000 vite para Krishtit dhe Papirusi i Ebersit rreth 1500 vite para Krishtit.

Në gjysmën e dytë të mesjetës, farmacia lëvizi jashtë Manastireve, u bë më e ndarë nga mjeksia dhe mori përgjegjësi dhe standarte të pavarura dhe fillimisht ky trend u shfaq në Itali, Spanjë dhe Francë, vënde që u furnizuan me njohuri shkencore nga civilizimi Arab. Për farmacinë influence Arabe qe shumë e rëndësishme, sepse del në pah dhe dallojmë lindjen e farmacistit të kualifikuar (al Soidalami) si funksionar me vehte dhe në gjysmën e parë të Sh.9. në Bagdat shfaqet farmacia më vehte, pra e ndarë nga mjeksia, Materia Medica Arabe, qe më e pasur, më e përpunuar dhe më elegante në administrimin e barnave dhe natyralisht instensifikuan nevojën e një farmacisti të ngritur dhe kualifikuar në fushën farmaceutike.

Në këtë periudhë dolën dhe veprat e mjekëve të shquar arabë si Rhazes (860-932), Avicena (980-1063) etj dhe u hodh poshtë teoria se barnat me shije të keqe vepronin më mirë, pra formëdozat e barnave të jenë më elegante, më të pëlqyeshme dhe u aplikua sheqerosja e shurupeve etj, ose veshja me argjent, ose ar e pilulave. Gjithashtu shkenca Arabe solli dhe barna, bimë dhe ide të reja në fushën e farmacisë. Idetë Arabe në Sh.13 kaluan në Spanjë dhe Italinë e Jugut. Gjithashtu kaloi dhe ndarja e farma-

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

cisë nga mjeksia dhe ne shek 13 Frederiku i dytë, sunduesi i mbretërisë të dy sicilive dekretoi për herë të parë në Europë ndarjen e farmacisë nga mjeksia dhe pozicioni i farmacisë u bë shumë i zhvilluar, shumë influencues dhe këtë dekret të Frederikut të dytë e quajtën “Magna Carta” e farmacisë dhe mjeksisë dhe këtu ndër të tjera kishte klauzola që kishin të bënin me kontrollin zyrtar, detyrimet e farmacistit të përgatitjeve të barnave cilësorë, të besueshme, kualitet të përshtatshëm, uniformed he me aftësi maksimale. Më vonë dolën dhe dy klauzolat e legjislacionit mbi numrin e farmacive dhe çmimin e barnave. Disa përgjegjësi dhe probleme të farmacisë dhe farmacistëve u shprehën më vonë në kodin e Genoa, ku ndër të tjera thuhej:

- Ne fiksojmë dhe urdhërojmë që çdo person që do të drejtojë ose mbajë një farmaci duhet të jetë liçensuar nga Master Farmacist ose të ashtuquajtur (speciarii).
- Asnjë farmacist nuk mund të thyej ligjet e profesionit, në të kundërtën do të ketë penalizime.
- Askush nuk mund të japë me pakicë shurupe, elixir, pilule, substanca të helmëta si arseniku etj, preparate të tjera farmaceutike, përveçse farmacisti i liçensuar etj. ligje dhe rregulla të tjera që sanksionojnë me ligje e rregulla shërbimin farmaceutik.

Me rënien e Kostandinopojës e v.1453 shënohet dhe fundi i periudhës mesjetare dhe shfaqet periudha e hershme moderne ajo e Rilindjes. Në këtë kohe Johan Gutenberg paraqiti makinën e shkrimit, Kolombi zbuloi Botën e Re, Vasco da Gama krijoi rrugën tregtare me Indinë, tregtia mori zhvillim të madh, shtypshkrimet e ndryshme në fushën mjeksore dhe farmaceutike, si p.sh në atë anatomike të Andrea Vasilins (1514-1564), apo ilustrimet e bimëve mjeksore si të Otto Brungels (1500-1534), Leonhart Fuchs (1501-1566), John Gerard (1545-1612) apo Dispensatori i Valerius Cordus që mbahet si Farmakopea e parë në V.1546 etj.etj dhe idetë e reja që lindën në zhvillimin e mjeksisë, nuk mund të shpjegoheshin më me idetë e mjeksisë humorale të Hipokratit dhe Galenit, që sundoi për rreth 1500 vite. Kritikën më të ashpër këtyre ideve e bëri Paracelsi, i cili në veprën e tij kritikoi jo vetëm teoritë e skolacizmin e Galenit, Avicënës, por dhe farmacistët e kohës dhe avokatia e tij për medikamentet e përgatitura kimikisht u bë shkëndija e rritjes të shkencës moderne farmaceutike. Profesion i farmacistit u zhvillua dhe modernizua dhe lindën shoqata dhe organizata që përfaqësonin farmacinë të cilat vendosën dhe kërkesa për provime, trainime dhe vendndodhje e farmacive. Kombinimi dhe zhvillimi i këtyre aftësive në kërkimet kimike, arritën të zbulojnë dhe izolojnë principet aktive të pastra kimike, sidomos në fushën e alkaloidëve, të

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

cilat mund të mateshin dhe identifikoheshin kimikisht, të ishin preparate të sigurta si barna të pastra, me efekt të sigurtë nga ana farmakologjike dhe terapeutike etj. dhe meqenëse veprimi i tyre ishte i qartë dhe i sigurtë, bëri që fiziologët gjatë studimeve shkencore të administronin barna egzakte dhe kjo u bë shkas për lindjen e farmakologjisë moderne. Ndër shkençarët farmacistë në këtë fushë po përmëdim një numër të vogël të tyre si p.sh. Friedrich Setürner që izoloi morphinën nga opiumi krud, apo Joseph Pelletier dhe Joseph Caventou izoluan disa alkalioide ndër ato dhe Chininën, apo Bernard Courtois zbuloi Jodin, apo Antoine Balard zbuloi bromin, apo Friedrich Ferdinand Runge prodhoi acidin carbolic dhe anilinën, etj.etj. shpikje dhe zbulime nga farmacistë dhe për ta mbyllur këtë kapitull deri tek bashkëkombasi jonë farmacisti Ferid Murati që në bashkëpunim me dy bashkëpunëtorë të tjerë morën çmimin Nobel për shpikjen e Viagrës. Gjithashtu zhvillim të madh morën institucionet e ndryshme shkencore, laboratorët kërkimorë, shoqatat dhe organizatat farmaceutike, ligjshmëria, fakultetet dhe kolegjet për studime në profesionin e farmacistit, specializime të ndryshme në fushën e farmacisë, revistat apo literature shkencore voluminoze, fabrikat e ndryshme të industrisë farmaceutike të hapura dhe të zhvilluara nga farmacistë si psh. fabrika farmaceutike Bayer Leverkusën themeluar më 01.08.1863 nga farmacisti Frederich Bayer, apo fabrika tjetër gjermane E. Merck Darmstadt themeluar nga farmacisti Frederic Jacob Merck v. 1668 sot në dhjetë fabrikat lider në Botë, etj. Ndër literaturat shkencore dhe fakultetet apo kolegjet për studime në fushën farmaceutike po përmëdim një numër jashtëzakonisht të vogël si psh. College de pharmacie në Paris v. 1777, Tranesdorf journal de Pharmacie et de Chimie v.1809, Philadelphia College of Pharmacy v.1821, Kolegji Farmacisë në Massachusetts v.1825, v.1912 mbahet në Hagë Asambleja e parë e Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike, v. 1948 mbahet Kongresi i parë Pan Amerikan i farmacisë dhe biokimisë, v.1820 botohet Farmakopea e parë Amerikane që sot ka arritur në numrin mbi tridhjetë e pesë, pa përmëndur Farmakopetë e shteteve të tjera si Angleze, Frënge, Italiane, Zvicriane, Belge, Ruse etj. apo Farmakopea Europiane, apo ajo Internacionale që është e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe numri i parë është botuar në v.1951, në v.1979 formohet Kolegji Amerikan i Farmacisë klinike, v.1986 formohet shoqata Amerikane e shkencëtareve farmacistë etj. Për mos u zgjatur më shumë se sot në Botë numurohen rreth 4 milion farmacistë në të gjitha fushat e shërbimit farmaceutik, institucionet shkencore dhe kërkimore, fabrikat prodhuese barnash, farmaci spitalore, farmaci rrjetit hapur, laboratore të ndryshme etj. me një nivel të lartë shkencor dhe profesional me specializimeve të ndryshme sipas fushës dhe sektorit që ushtrojnë pro-

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

fesionin e tyre, psh që të punosh në një farmaci spitalore duhet të keshë një specializim katër vjeçar për këtë problem etj.

Më poshtë po japim disa definicione mbi farmacinë: Farmacia është përcaktuar si një profesion i lidhur me artin dhe shkencën (pra është art dhe shkencë) e përgatitjes nga burime natyrore dhe sintetike të barnave dhe medikamenteve për distribuimin dhe përdorimin në mjekimin dhe preventimin e sëmundjes. Ajo përfshin dituri mbi identifikimin, zgjedhjen, veprimin farmakologjik, ruajtjen, kombinimin, analizën dhe standartizimin e barnave dhe medikamenteve. Gjithashtu përfshin interpretimin e recetave, përbërjen, rishikimin e zgjedhjes produktit medikamentoz dhe përdorimit barit, monitorimin dhe ndërhyrjen e pacientit. Shoqata Amerikane farmaceutike e përshkruan misionin e farmacisë në shërbim të shoqërisë, si një profesion përgjegjës për përdorimin dhe shërbimin e përshtatshëm të barnave dhe artikujve mjeksorë, për të arritur rezultate optimale terapeutike. Raporti komisionit të farmacisë "Farmacisti për të ardhmen, deklaroi se farmacia duhet të ideohet kryesisht si një sistem njohurish që të çon në një shërbim mjeksor që lidhet me kuptimin e barnave dhe efektit të tyre dhe kujdesi farmaceutik është një element i domosdoshëm i kujdesit total shëndetsor. Ky koncept shpreh rolin, rëndësinë dhe përgjegjësinë e farmacistit në terapinë medikamentoze dhe arritjeve përfundimtare në kualitetin e jetës të pacientit.

HEPATITI KRONIK C, SËMUNDJE QË SHËROHET PLOTË- SISHT. CHRONIC HEPATITIS C, A COURABLE DISEASE

Jovan BASHO

Shërbimi Hepatologji/ Gastroenterologji, QSU "Nënë Tereza", Tiranë.

Infeksioni prej virusëve C (deri sot janë konfirmuar 7 të tillë) është një prej infeksioneve më të përhapur e më problematike në mbarë botën. Sipas të dhënave të vitit 2019 (dmth para pandemisë së Covid-19), në botë kishte 58 milion njerëz me hepatopati kronike C. Prej tyre rreth 400 000 vetë vdesin çdo vit. Në vitin 2016 OBSH paraqiti një plan ambicioz për ta eliminuar këtë sëmundje deri në vitin 2030, gjë kjo e bazuar në mjekimet e sotme: antivirale me veprim të drejtpërdrejtë. Deri në vitin 2019, u diagnostikuan vetëm 21% nga 58 milion njerëz me hepatite kronike C, ndërkohë që vetëm 13% u mjekuan. Progresi shumë i madh i bërë vitet e fundit në zbulimin e barnave me veprim antiviral të drejtpërdrejtë (frenusit e proteazave dhe polimerazës) kanë bërë që kjo sëmundje të konsiderohet si sëmundje e shërueshme. Kështu, janë zbuluar shumë barna që frenojnë proteazën (me prapashtesën ...previr), proteinën jo strukturore virale NS5A (me prapashtesën ...asvir) dhe polimerazën (me prapashtesën ...buvir), në bashkëshoqërime farmakologjike nga më të ndryshmet. Këto barna kanë bërë që dëmtimet e mëlçisë nga virusi C, të shihen sot si dëmtime plotësisht të shërueshme, pavarësisht gjendjes morfologjike dhe funksionale të mëlçisë në momentin e diagnozës. Për më tepër janë përcaktuar edhe gjendjet rezistente ndaj mjekimit të lidhura kryesisht me barnat që frenojnë NS5A. Në vendin tonë rimbursohen thuajse të gjitha barnat DAA. Kërkimet farmakologjike të viteve të fundit kanë bërë që të marrë përparësi mjekimi me bashkëshoqërimin Sofosbuvir + Velpatasvir, Sofosbuvir + Daclatasvir dhe Glecaprevir + Pibrentasvir (gjenotipet 1-6) dhe Grazoprevir + Elbasvir (gjenotipet 1,4). Ndërkohë bashkëshoqërim tepër i efektshëm, në rastet e rralla rezistente ndaj barnave të para është bashkëshoqërimi: Sofosbuvir + Velpatasvir + Voxilaprevir.

Në qershor të këtij viti (2022), OBSH, paraqiti strategjitë e saj për vitin 2030, për të pakësuar infeksionin nga HCV në masën 90% dhe vdekjet në masën 65%. Për këtë gjë nevojitet thjeshtësimi i shërbimit mjekësor duke

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

ia ngarkuar mjekimin mjekut të përgjithshëm, thjeshtësimi dhe përhapja masive e testimit të ngarkesës virale të virusit, HCV RNA dhe shtrirjen e mjekimit edhe tek fëmijët dhe adoleshentët.

Të gjitha këto kanë rritur ndjeshëm shpresën e mjekëve dhe të sëmurëve për mundësi të mëdha mjekimi, në luftën për shrrënjosjen e virusit C, pa varësisht stadi klinik e morfologjik në të cilin zbulohet patologjia hepatike.

Fjalë kyçe: HCV, DAA (direct acting antivirals), goals of WHO for 2030.

ROLE OF ORAL CONTRACEPTIVE ESTROGEN RECEPTOR LIGANDS IN HUMAN ENDOTHELIAL CELLS FUNCTION

Aida Dama

Albanian University, University of Padova

Ethinylestradiol (EE) and estetrol (E4) are the two main estrogenic agents used in combined oral contraceptives. These compounds have different binding affinity to and efficacy on estrogen receptors (ER) subtypes. EE product contained in numerous formulations of combined oral contraceptives and E4 normally produced during pregnancy and used in combined oral contraceptives, which contain drospirenone, approved by the FDA and EMA in 2021.

Treatment with estrogenic agents enhances angiogenesis via nongenomic, G protein-coupled estrogen receptor (GPER)-dependent mechanisms. However, the impact of EE and E4 on human endothelial function has been little investigated. EE and E4 (10^{-9} – 10^{-7} M) significantly enhanced migration of human umbilical vein endothelial cells (HUVECs) using scratch and Boyden chamber assays. Treatment with increasing concentrations of EE, but not E4, enhanced accumulation of the glycolysis activator PFKFB3. Of note, effects of EE and E4 on endothelial migration and signalling proteins were abolished by addition of the GPER antagonist G36 (10^{-6} M).

Thus, EE and E4 induced comparable endothelial responses in vitro, suggesting no apparent alterations of vascular remodelling and regeneration capacity by oral contraceptives containing these agents.

Keywords: Ethinylestradiol, estetrol, G protein-coupled estrogen receptor, PFKFB3, migration

ÇRREGULLIMET E ANKTHIT PAS COVID-IT. MEKANIZMAT MBROJTËSE TË TIJ.

Dr. Shk. Vjollca DIMOSHI

Crregullimet e ankthit jane semundjet psikiatrike me te zakonshme ne popullaten e pergjithshme. Crregullimet e ankthit jane shtuar shume gjate peridhese se pandemise se kovitit por edhe me pas , Ate i takojme me shpesh ne personat qe kane kaluar kovitin ne gjendje te rende por dhe te e mesme. Crregullimet e ankthit shpesh shoqerohen me cregullime te humorit si crregullimi depresiv madhor ose ai bipolar dhe mund te shkaktoje nje komplikacion fatal per jeten sic eshte suicidi

Ceshte ankthi? Ankthi ka tension, shqetesim, nganjehere dhe tmerr. Ai rrjedh nga burime qe nuk jane te dukshme nga personi qe e perjeton ose qe duken te parendesishem ne krahasim me reaksionin intensive emocional te tij. Ankthi lidhet me ritjen e aktivitetit te sistemit nervor simpatik, i cili manifestohet me shenja fizike, si djersitje, rrahje te shpejta te zemres, frymarrje te shpejtuar dhe shqtesim gastrointestinal . Ne shumicen e rasteve ankthi karakterizohet nga nje reagim i tepruar ndaj ngjarjeve te lehta stresante. Ankthi quhet patologjik kur ai nderhyn ne veprimtarine ditore, ne arritjen e qellimeve te deshiruara, ose ne rehatine e arsyeshme emocionale. Ankthi situacional cfaqet si pergjigje e nje stresori specifik dhe mbaron me largimin etij. Njerezit qe paraqiten per mjekim kane me shpesh atakun e paniku (ankthin akut) dhe crregullimin e ankthit te pergjitheshuar si dhe crregullimin obsesivo-kompulsiv.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

IDENTIFIKIMI I PËRGATESAVE PEDIATRIKE QË MUNGOJNË NË TREGUN FARMACEUTIKE SHQIPTAR

Prof. Ledjan Malaj, Prof. Asoc. Ela Hoti

Departamenti i Farmacisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Hyrje. Shumë barna të miratuara për përdorim tek të rriturit nuk janë të miratuara për përdorim në popullatën pediatrike. Studimi ynë ka për qëllim të identifikojë barnat dhe formë dozat të cilat përshekruhen në pediatri por që për arsye të ndryshme nuk gjenden në Republikën e Shqipërisë.

Metodika. Është bërë një analizë e thelluar e barnave që përdoren në sëmundjet kardiovaskolare, gastrointestinale, të tiroides dhe diuretike. Për të mbledhur informacionet janë përdorur regjistrat e barnave të viteve 2015, 2021, 2022 dhe meqënëse regjistri i barnave nuk lejon ekstraktimin e barnave të disponueshme në treg dhe të lëndëve vepruese të klasifikuara sipas grupmoshës në të cilën përdoren, u analizuan fletëudhëzueset që ndodhen në kutinë e paketimit dhe/ose përmbledhja e karakteristikave të produktit. Gjithashtu u nxorrën dhe u analizuan dhe eksipientët e këtyre barnave.

Rezultate. Nga hulumtimi u vu re se ekziston një problem serioz në lidhje me mungesën e formulimeve të përshtatshme për popullatën pediatrike. Përdorimi i pamiruar dhe “jashtë etikete” i produkteve mjekësore në pacientët pediatrikë i dedikohet mungesës së formulimeve pediatrike dhe të dhënave të pamjaftueshme nga studimet klinike, të cilat duhet të kryhen për të vërtetuar efektshmërinë dhe sigurinë e barnave në popullatën pediatrike. Shumë eksipientë që përdoren në formulën e produkteve të tregut nuk janë të lejuara për fëmijët e vegjël. Autoritetet Shëndetësore duhet të përcaktojnë sasinë maksimale ditore të lejuar të një eksipienti të caktuar të marrë gjatë terapisë dhe të vlerësojnë efektin dëmtes të këtyre lëndëve në pacientët pediatrikë. Përgatesat galenike janë një zgjidhje e mirë në rast të mungesës së barnave të përshtatshme për t’u përdorur tek fëmijët ose në rast mungese të përkohshme të atyre ekzistuese. Galenika klinike pediatrike është një instrument i vlefshëm për të garantuar një terapi të personalizuar për pacientin e vogël.

Fjalët kyçe: galenikë klinike pediatrike, terapi e personalizuar, përdorim i pamiruar dhe/ose “jashtë etikete”

IDENTIFICATION OF PEDIATRIC PREPARATIONS THAT ARE NOT AVAILABLE IN THE ALBANIAN PHARMACEUTICAL MARKET

Prof. Ledjan Malaj, Prof. Asoc. Ela Hoti

Department of Pharmacy, Univesity of Medicine, Tirana

Introduction. Many drugs approved for use in adults are not approved for use in the pediatric population. Our study aims to identify the drugs and dosage forms which are prescribed in pediatrics but which for various reasons are not obtainable in the Republic of Albania.

Methods. An in-depth analysis of drugs used in cardiovascular, gastrointestinal, thyroid and diuretic diseases has been done. To collect the information, the drug registers of the years 2015, 2021, 2022 were used, and since the drug register does not allow the extraction of drugs available on the market and active substances classified according to the age group in which they are used, their leaflet were analyzed and/or the summary of product characteristics. The excipients of these drugs were also identified and analyzed.

Results. From the research it was observed that there is a serious problem regarding the lack of suitable formulations for the pediatric population

The unapproved and “off-label” use of medical products in pediatric patients is due to the lack of pediatric formulations and insufficient data from clinical studies, Which should be performed to prove the effectiveness and safety of drugs in the pediatric population. Many excipients used in the formula of marketed products are not approved for young children. Health authorities should determine the maximum daily amount allowed of a certain excipient taken during therapy and evaluate the harmful effect of these substances in pediatric patients.

Galenic preparations are a good solution in case of lack of drugs suitable for use in children or in case of temporary absence of existing ones. Pediatric clinical galenics is a valuable instrument to guarantee a personalized therapy for the little patient.

Keywords: pediatric clinical galenics, personalized therapy, off-label and/or non approved use

INFLAMACIONET E LËKURËS NË GRUPMOSHËN PEDIATRIKE DHE PËRDORIMI I PREPARATEVE BIMORE NË TRAJTIMIN E TYRE

Dorina Shengjergji Dervishi¹, Emi Panariti², Arnisa Nuna²,

¹Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Europian i Tiranës, Shqipëri

²Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University, Shqipëri

³ Farmaci Rrjeti

Hyrje: Inflamacionet e lëkurës që janë më të zakonshme dhe që prekin më shumë grupmoshën pediatrike janë rash, dermatiti atopik, infeksionet mykotike, psoriaza. Përdorimi i preparateve bimore në trajtimin e sëmundjeve inflamatore të lëkurës rezulton nga ndikimi i tyre në faza të ndryshme të inflamacionit.

Qwllimi: Të jepet një trajtim teorik i inflamacioneve të lëkurës më të shpeshta në grupmoshën pediatrike, të analizohet aktiviteti anti-inflamator, mekanizmi i veprimit, efektet anësore të bimëve mjekësore në lidhje me trajtimin e këtyre inflamacioneve dhe të arrihen në përfundime mbi përdorimin e duhur të tyre në grupmoshën pediatrike.

Metodologjia: Për realizimin e këtij studimi retrospektiv dhe analitik janë përdorur burime të shumta informacioni nga rishikimi i literaturave si dhe nëpërmjet një pyetësi të realizuar rastësisht në 120 farmaci të rrjetit të hapur të vendit tonë, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna mbi rastet e grupmohave pediatrike që janë paraqitur me inflamacione të lëkurës dhe përdorimin e preparateve bimore për trajtimin e tyre.

Rezultatet: Gjatë studimeve të literaturave mbi inflamacionet e lëkurës më të shpeshta në grupmoshën pediatrike u evidentuan rash, dermatiti atopik, infeksionet mykotike, psoriaza, folikuliti, furunkuli, carbuncles. Gjatë viteve të fundit ndër bimët më të përdorura lokalisht për trajtimin e tyre përmenden *Matricaria recutita*, *Calendula officinalis*, *Aloe Vera* *Echinacea purpurea*, *Oenothera biennis*, *Linum Usitatissimum* etj. Nga pyetësi i realizuar një pjesë e konsiderueshme e farmacistëve raportuan se rastet e paraqitura në farmaci për inflamacionet e lëkurës në moshë pediatrike janë dermatiti atopik (45%), rash (17%) dhe infeksionet mykotike (12%). Përsa i përket mënyrës së përdorimit të këtyre preparateve 57% e tyre raportuan se ato përdoren lokalisht si terapi e kombinuar me atë konvencionale. Far-

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE

macistët raportuan që preparatet bimore më të përdorura lokalisht janë ato me Aloe vera (31%), 13% e tyre raportuan ato me Calendula officinalis dhe 5% e tyre raportuan preparate me Matricaria recutita. Ndërkohë 48% e tyre raportuan se janë përdorur preparate të kombinuara të këtyre bimëve. Më së shumti janë farmacistët ato që sugjerojnë përdorimin e këtyre preparatëve bimore (48.31%). Gjithashtu 65% e tyre mendojnë se gjatë viteve të fundit është rritur përdorimi i preparatëve bimore për trajtimin e inflamacioneve të lëkurës në grupmoshat pediatrike,

Përfundimet: Bimët mjekësore janë një burim i pasur i përbërësve aktivë dhe mund të jene efikase për trajtimin e inflamacioneve të lëkurës në grupmoshën pediatrike. Me rritjen e përdorimit të tyre gjatë viteve të fundit, nevojiten kërkime të mëtejshme në lidhje me efikasitetin, sigurinë, përdorimet optimale dhe standardizimin e preparatëve bimore.

Fjalë kyçe: inflamacione të lëkurës, preparate bimore, grupmosha pediatrike

BARNAT E FALSIFIKUARA, RREZIK NË RRRITJE PËR SHËNDETIN E POPULLATËS

Defrim Goma¹, Andreina Rebi²

¹Sekretar i Përgjithshëm UFSH

²Farmaciste

Barnat e falsifikuara dhe nën standard janë një problem botëror i kujdesit shëndetësor me permasa pandemike. Ato shoqërohen me dhjetëra mijëra vdekje, kryesisht tek fëmijët e vegjël në vendet e varfra. Pasojat nuk janë të kufizuara vetëm drejt vendeve më pak të zhvilluara, por janë të pranishme edhe në ato të zhvilluara.

Duke qenë të vetëdijshëm për këtë krizë shëndetësore globale, autoritetet qeverisëse po zhvillojnë kushte më të rrepta për të penguar shkeljen e zinxhirit të ligjshëm të furnizimit. Sidoqoftë, për të mbrojtur shëndetin publik dhe për të rritur ndërgjegjësimin, bashkëpunimi nga të gjithë palët e interesuara legjitime dhe bashkëpunimi i organizatave jofitimprurëse janë thelbësore. Profesionisti i kujdesit shëndetësor, si hallka e fundit e zinxhirit të furnizimit dhe shpërndarjes, është përgjegjëse për barnat e siguruar dhe duhet të jetë në gjendje të garantojnë cilësinë dhe sigurinë për të siguruar mirëqenien e pacientëve. Mbrojtja e shëndetit të pacientit dhe sigurimi i barnave me cilësi të lartë, të sigurtë dhe efektivë duhet të jetë përparësia më e lartë e personave që ofrojnë kujdesin shëndetësor dhe industrisë farmaceutike.

Një furnizim i sigurt me barna është thelbësor për shëndetin publik. OBSH është shfaqur kohët e fundit si udhëheqësi global në betejën kundër barnave me cilësi të ulët dhe kompanitë farmaceutike kanë rritur rolet e tyre në sigurimin e integritetit të zinxhirëve të furnizimit me barna. Pavarësisht përmirësimeve në mbikëqyrje dhe teknologjisë së identifikimit të cilësisë së barnave, kërkohen ende më shumë përpjekje në studim, politika dhe monitorim në terren për të ndaluar përhapjen e barnave të tilla.

Fjalët kyçe: bar i falsifikuar, bar nën standard, pasoja shëndetësore, efekt i padëshiruar, shëndeti publik.

COUNTERFEIT DRUGS, AN INCREASED RISK TO THE HEALTH OF THE POPULATION

Defrim Goma¹, Andreina Rebi²

¹General Secretary of PhOA

²Pharmacist

Falsified medicines are a global healthcare problem of pandemic dimensions.

Falsified and substandard medicines are associated with tens of thousands of deaths, mainly in young children in poor countries. The consequences are not limited to the less regulated countries; they also impact on the more highly regulated ones. Being aware of this global public health crisis, government authorities are developing more stringent environments to impede the breach of the legitimate supply chain.

However, to protect public health and raise awareness, cooperation on the part of all legitimate stakeholders and collaboration of not-for-profit organisations are crucial. The healthcare professional, as last link of the supply-and-distribution chain, is responsible for the medicines provided and needs to be able to guarantee the quality and safety to ensure the wellbeing of patients. Protecting the health of the patient and ensuring high quality, safe and effective medicines must be the highest priority of healthcare providers and the pharmaceutical industry.

A safe medicines supply is fundamental for public health. The WHO has emerged recently as the global leader in the battle against poor-quality drugs, and pharmaceutical companies have increased their roles in assuring the integrity of drug supply chains. Despite advances in drug quality surveillance and detection technology, more efforts are urgently required in research, policy, and field monitoring to halt the pandemic of these drugs.

Keywords: falsified drug, substandard drug, health consequences, adverse effect, public health.

KONFERENCA E VI FARMACEUTIKE